



AXHENDA e GRAVE RURALE

Agenda delle Donne Rurali

Bashkia - Comune
Lezhë



Gruaja tek Gruaja



Sostegno all'uguaglianza di genere, ai diritti e all'empowerment economico delle donne rurali nel nord dell'Albania

Bashkia - Comune
Lezhë

AXHENDA e GRAVE RURALE

Agenda delle Donne Rurali



10

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



CENTRO
INFORMAZIONE E
EDUCAZIONE ALLO
SVILUPPO ONLUS



Gruaja tek Gruaja

cospe

TOGETHER FOR CHANGE





Subjekti zbatues - Ente realizzatore: *CIES Onlus e Gruaja tek Gruaja - COSPE e Hapa te Lehte*

Eksperte për çështjet gjinore - Esperta per le questioni di genere: *Atila Uligaj, Gruaja tek Gruaja - Rozeta Gradeci, COSPE - Ana Mila, Hapa te Lehte*

Hartuar nga Redatto da: *Antonello Massenti, Cies*

Ky botim është realizuar me kontributin e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e OJF-ve partnere të projektit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë.

Ndalohet riprodhimi ose transmetimi i çfarëdo pjese të këtij botimi, me çdo mjet ose në çdo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të zoteruesit të të drejtave të autorit.

Questa pubblicazione è stata realizzata con il contributo della Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo. I contenuti di questa pubblicazione sono di esclusiva responsabilità delle ong partner e non rappresentano necessariamente il punto di vista dell'Agenzia

È vietata la riproduzione o la trasmissione di qualsiasi parte di questa pubblicazione, con qualsiasi mezzo o in qualsiasi forma, senza preventiva autorizzazione scritta da parte del titolare dei diritti d'autore

Fotografitë - Fotografie: *Gra te Grupat Burimor Lezhë / Donne dei Gruppi Risorsa di Lezhë*

Grafika e Design - Grafica e Design: Antonello Massenti

www.aics.gov.it

www.cies.it

www.cospe.org

www.gtg.al

www.hapatelehte.org

01

HYRJA - INTRODUZIONE

Konteksti	01
Contesto	
Metodologija	02
Metodologia	

02

ÇËSHTJET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NE BLINISHT - BALLDREN - DAJÇ - KALLMET PRINCIPALI PROBLEMATICHE EMERSE A BLINISHT - BALLDREN - DAJÇ - KALLMET

 Drejtësi dhe Ligjshmëri	05
Giustizia e Legalità	
 Mirëqenia Sociale dhe Shëndetësi	09
Cura Sociale e Sanità	
 Infrastruktura dhe Zhvillimi	15
Infrastrutture e Sviluppo	
 Kultura dhe Arsim	17
Cultura e Educazione	
 Fuqizimi Ekonomik	19
Empowerment economico	

PËRMBAJTJA INDICE


03

ÇËSHTJET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NE SHËNGJIN PRINCIPALI PROBLEMATICHE EMERSE A SHËNGJIN

 Mirëqenia Sociale	28
Cura Sociale	
 Shërbimet shëndetësore	36
Servizi per la salute	
 Fuqizimi Ekonomik	42
Empowerment economico	
 Infrastruktura dhe Zhvillimi	48
Infrastrutture e Sviluppo	

HARTA E BASHKISË LEZHË

CARTA DELLA MUNICIPALITÀ DI LEZHE



Sipas të dhënave më të fundit të regjistrimit të vitit 2023, Bashkia Lezhë shtrihet në një sipërfaqe prej **509 km²** dhe ka një popullsi totale prej **51.354 banorësh**.

Shpërndarja sipas gjinisë

Meshkuj: 25.602 (49,9%)

Femra: 25.752 (50,1%)

Secondo i dati più recenti del censimento del 2023, la Bashkia di Lezhë si estende su un'area di **509 km²** e ha una popolazione totale di **51.354 abitanti**.

Distribuzione di genere

Uomini: 25.602 (49,9%)

Donne: 25.752 (50,1%)

Konteksti

Bashkia e Lezhës përbëhet nga **10 njësi administrative** dhe shtrihet në **një territor të larmishëm** që përfshin zona bregdetare, fushore, kodrinore dhe malore, duke krijuar një kontekst të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit, ku rreth **40% e popullsisë jeton në zonat rurale**.

Ekonomia lokale është e diversifikuar dhe mbështetet kryesisht në sektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit në zonat rurale, ndërsa në qytetin e Lezhës dhe në zonat bregdetare mbizotërojnë tregtia dhe shërbimet. Pozicioni i favorshëm gjeografik, i lidhur me lumin Drin, lagunat Kunë–Vain dhe vijën e gjatë bregdetare të Shëngjinit, krijon një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit bregdetar, kulturor dhe natyror.

Brenda kësaj strukture ekonomike, **qyteti bregdetar i Shëngjinit** përfaqëson një nga motorët kryesorë të zhvillimit lokal. Porti i Shëngjinit dhe aktivitetet e lidhura me peshkimin, transportin e mallrave dhe turizmin sezonal kontribuojnë ndjeshëm në ekonominë e bashkisë dhe në krijimin e vendeve të punës. Gjatë sezonit veror, zona përjeton një rritje të madhe të popullsisë për shkak të fluksit të vizitorëve, duke rritur kërkesën për strehim, transport, shërbime publike dhe infrastrukturë.

Megjithatë, kjo rritje sezonale sjell edhe **sfida të rëndësishme** që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, furnizimin me ujë, rrjetet e kanalizimeve dhe trafikun, duke ushtruar presion të konsiderueshëm mbi kapacitetet e shërbimeve publike dhe duke kërkuar një planifikim territorial më të qëndrueshëm.

Nga **pikëpamja sociale**, Bashkia përballlet me disa sfida që lidhen me pabarazitë territoriale dhe mundësitë e kufizuara për disa kategori të popullsisë, veçanërisht për gratë dhe vajzat në zonat rurale. Megjithëse ekzistojnë disa struktura komunitare dhe shërbime sociale që ofrojnë informim, këshillim dhe mbështetje për familjet në vështirësi dhe grupet vulnerabel, **qasja në këto shërbime nuk është e njëtrajtshme** në të gjithë territorin.

Gratë në zonat rurale shpesh luajnë një rol thelbësor në ekonominë familjare përmes aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale, por vazhdojnë të përballen me **pengesa në aksesin në tregun formal** të punës, në mundësitë e sipërmarrjes dhe në proceset vendimmarrëse lokale. Për më tepër, infrastruktura e pamjaftueshme, lidhjet e kufizuara të transportit dhe distanca nga qendrat urbane ndikojnë negativisht në aksesin në arsim, në shërbimet shëndetësore dhe në mundësitë ekonomike.

Contesto

Il Comune di Lezhë è composto da **10 unità amministrative** e si estende su un **territorio diversificato** che comprende aree costiere, pianeggianti, collinari e montane, creando un contesto rilevante per lo sviluppo economico e sociale della regione, dove circa il **40% della popolazione vive nelle zone rurali**.

L'**economia locale** è diversificata e si basa principalmente sui settori dell'agricoltura, dell'allevamento e della pesca nelle aree rurali, mentre nella città di Lezhë e nelle aree costiere prevalgono il commercio e i servizi. La posizione geografica favorevole, legata al fiume Drin, alle lagune di Kunë–Vain e alla lunga fascia costiera di Shëngjin, crea un notevole potenziale per lo sviluppo del turismo balneare, culturale e naturalistico.

All'interno di questa struttura economica, la **città costiera di Shëngjin** rappresenta uno dei principali motori dello sviluppo locale. Il porto di Shëngjin e le attività connesse alla pesca, al trasporto delle merci e al turismo stagionale contribuiscono in modo significativo all'economia del comune e alla creazione di posti di lavoro. Durante la stagione estiva, l'area registra un forte aumento della popolazione a causa dell'afflusso di visitatori, con un conseguente incremento della domanda di alloggi, trasporti, servizi pubblici e infrastrutture.

Tuttavia, questa crescita stagionale comporta anche **importanti sfide** legate alla gestione dei rifiuti, alla fornitura di acqua, alle reti fognarie e al traffico, esercitando una pressione significativa sulle capacità dei servizi pubblici e richiedendo una pianificazione territoriale più sostenibile.

Dal **punto di vista sociale**, la Municipalità affronta diverse sfide legate alle disuguaglianze territoriali e alle opportunità limitate per alcune categorie della popolazione, in particolare per donne e ragazze nelle aree rurali. Sebbene siano presenti alcune strutture comunitarie e servizi sociali che offrono informazione, consulenza e sostegno alle famiglie in difficoltà e ai gruppi vulnerabili, **l'accesso a tali servizi non è uniforme** su tutto il territorio.

Le **donne nelle aree rurali** svolgono spesso un ruolo fondamentale nell'economia familiare attraverso attività agricole e di allevamento, ma continuano a incontrare **ostacoli nell'accesso al mercato del lavoro** formale, alle opportunità di imprenditorialità e ai processi decisionali locali. Inoltre, infrastrutture carenti, limitati collegamenti di trasporto e la distanza dai centri urbani incidono negativamente sull'accesso all'istruzione, ai servizi sanitari e alle opportunità economiche.

Metodologjia

Agjendat e Grave Rurale janë realizuar në kuadër të projektit “**Mbështetje për barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale në veri të Shqipërisë**” AID 12819, i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe i zbatuar nga CIES Onlus në partneritet me COSPE, Gruaja tek Gruaja dhe Hapa të Lehtë.

Hartimi i Agjendës për Bashkinë Lezhë është zhvilluar **drejtpërdrejt nga 55 gratë**, të moshave dhe shtresave të ndryshme shoqërore, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve të marginalizuara (nënat e vetme, gratë e moshuara dhe të rinjtë e zonave të thella rurale), me lehtësimin e stafit të organizatës **Gruaja tek Gruaja** dhe **CIES** në Shëngjin dhe **Hapa te Lehte** dhe **COSPE** në Dajç, Lezhë dhe Blinisht.

Gratë u përfshinë në një **proces pjesëmarrës të ndarjes dhe bashkëpunimit**, që kombinon të dhënat ekzistuese me zërin e grave dhe vajzave të komunitetit. Procesi u bazua në parimet e barazisë gjinore, përfaqësimit të barabartë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në vendimmarrje, duke garantuar për gratë pjesëmarrëse **një hapësirë të mbrojtur për shprehje të lirë dhe demokratike**.

Qasja metodologjike përfshin **4 faza të veçanta**:

1. **Analiza e kontekstit**: shqyrtimi i dokumenteve bashkiake, statistikave dhe raporteve institucionale për të kuptuar sfidat strukturore.
2. **Konsultimet komunitare**: takime me gra dhe vajza nga të gjitha njësitet administrative për të identifikuar problemet më të rëndësishme në fushat e shërbimeve sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimit dhe infrastrukturës.
3. **Analiza dhe formulimi i rekomandimeve**: përkthimi i rezultateve të procesit të zhvilluar me gratë në propozime konkrete politike dhe institucionale për bashkinë dhe aktorët vendorë.
4. **Veprimet pilot**: realizimi i një mikroprojekti komunitar të identifikuar nga vetë gratë për t’iu përgjigjur një nevojë të tyre.

Të dhënat u përpunuan sipas qasjes “**problematicë > ndikim gjinor > zgjidhje e propozuar**”, duke ndërtuar për çdo fushë tematike një strukturë që lidh sfidat me pasojat gjinore dhe aktorët përgjegjës. Rezultatet përfundimtare u përmbledhën në **tabela tematike** që shërbejnë si bazë për planifikim, advokim dhe buxhetim me ndjeshmëri gjinore.

Metodologia

Le Agende delle Donne Rurali sono state realizzate nell’ambito del progetto “**Sostegno all’uguaglianza di genere, ai diritti e all’empowerment economico delle donne rurali nel nord dell’Albania**” AID 12819, finanziato dalla Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo e implementato dal CIES Onlus in partnership con COSPE, Gruaja tek Gruaja e Hapa te Lehte.

La **redazione dell’Agenda** per il Comune di Lezhë è stata realizzata **direttamente da 55 donne**, di diverse età ed estrazione sociale, con particolare attenzione ai gruppi marginalizzati (madri single, donne anziane e giovani delle aree rurali più remote) con la facilitazione del personale di **Gruaja tek Gruaja** e **CIES** per l’area di Shëngjin e di **Hapa te Lehte** e **COSPE** per le aree di Blinisht, Balldren, Dajç e Kallmet.

Le donne sono state coinvolte in un **percorso partecipato di condivisione**, che combina i dati esistenti con la voce delle donne e delle ragazze della comunità. Il processo si è basato sui principi di uguaglianza di genere, pari rappresentanza e partecipazione inclusiva ai processi decisionali, garantendo alle donne partecipanti uno **spazio protetto di espressione libera e democratica**.

L’approccio metodologico include infatti **4 fasi distinte**:

1. **Analisi contestuale**: esame dei documenti comunali, delle statistiche e dei rapporti istituzionali per comprendere le sfide strutturali.
2. **Consultazioni comunitarie**: incontri con donne e ragazze provenienti da tutte le unità amministrative per identificare i problemi più rilevanti nei settori dei servizi sociali, della sanità, dell’occupazione, dell’istruzione e delle infrastrutture.
3. **Analisi e formulazione delle raccomandazioni**: traduzione dei risultati del percorso svolto con le donne in proposte politiche e istituzionali concrete rivolte al comune e agli attori locali.
4. **Azioni pilota**: realizzazione di un microprogetto comunitario identificato dalle donne per rispondere ad un loro bisogno.

I dati sono stati elaborati secondo l’approccio “**problematica > impatto di genere > soluzione proposta**”, costruendo per ogni area tematica una struttura che collega le sfide alle conseguenze di genere e agli attori responsabili. I risultati finali sono stati sintetizzati in **tabelle tematiche** che fungono da base per la pianificazione, l’advocacy e la definizione di bilanci sensibili al genere.

Axhenda e Grave Rurale Agenda delle Donne Rurali

Agjenda e Grave Rurale të Lezhë ka një strukturë të ndryshme krahasuar me ato të përgatitura në Bashkitë e tjera të përfshira në projektin AID 12819. Territori i saj është shumë i madh dhe kompleks, ku të gjithë partnerët e projektit kanë ndërhyrë, duke vepruar në njësi administrative të ndryshme.

Më konkretisht, **CIES dhe GtG** krijuan një Grup Burimi me gra nga zonat e **Shëngjin**, duke përfshirë 28 gra. Ndërkohë, **COSPE dhe HtL** kanë punuar në territoret e **Blinisht, Balldren, Dajç e Kallmet**, duke përfshirë edhe 23 gra të tjera.

Ky aspekt operacional bëri të nevojshme strukturuar një dokument që të ishte në gjendje të pasqyroste gjerësisht atë që ishte punuar nga të **dy Grupet Burimi**, si në aspektin e prioriteteve dhe problemeve të dalura, ashtu edhe, mbi të gjitha, me referencë të zgjidhjet e mundshme për t'i adresuar ato, në një perspektivë të vlerësimit të rolit social dhe ekonomik të grave.

Më poshtë do të jetë e mundur të lexohet në mënyrë të radhitur gjithë ajo që është punuar nga Grupi Burimi i koordinuar nga COSPE dhe HtL dhe më pas gjithë ajo që ka dalë gjatë rrugëtimit të realizuar nga Grupi Burimi i koordinuar nga CIES dhe GtG.

L'Agenda delle Donne Rurali di Lezhe ha una struttura differente rispetto a quelle elaborate nelle altre Municipalità coinvolte nel progetto AID 12819. Il suo è infatti un territorio molto vasto e complesso nel quale tutti i partner di progetto sono intervenuti, operando in differenti unità amministrative.

Piu in particolare **CIES e GtG** hanno costituito un Gruppo Risorsa con donne provenienti dalle aree di **Shëngjin** coinvolgendo 28 donne. **COSPE e HtL** invece hanno lavorato nei territori di **Blinisht, Balldren, Dajç e Kallmet** coinvolgendo altre 23 donne.

Questo aspetto operativo ha reso necessario strutturare un documento che fosse in grado di riportare in modo ampio quanto elaborato dai **due Gruppi Risorsa**, sia in termini di priorità che di problematiche emerse, sia soprattutto con riferimento alle possibili soluzioni proposte per affrontarle in un'ottica di valorizzazione del ruolo sociale ed economico femminile.

Di seguito quindi sarà possibile leggere in sequenza tutto quanto elaborato dal Gruppo Risorsa coordinato da COSPE e HtL e quindi tutto quanto è emerso durante il percorso realizzato dal Gruppo Risorsa coordinato da CIES e GtG.

Çështjet kryesore të identifikuara nga Grupi i Burimore COSPE/HtL

Principali
problematiche emerse
dal Gruppo Risorsa
COSPE/HtL



Drejtësi dhe
Ligjshmëri
Giustizia e
Legalità



Mirëqenia
Sociale
Cura
Sociale



Kultura dhe
Arsim
Cultura e
Educazione



Infrastruktura
dhe Zhvillimi
Infrastrutture
e Sviluppo



Fuqizimi
Ekonomik
Empowerment
economico

Blinisht – Balldren – Dajç – Kallmet



Përsheptimi i legalizimit të banesave dhe pronave të paluajtshme

Accelerazione della legalizzazione delle abitazioni e delle proprietà immobiliari

Pas më shumë se dy dekadash që nga fillimi i procesit të legalizimit në vitin 2001, shumë familje përballen ende me **vonesa dhe pengesa administrative** që dëmtojnë sigurinë juridike të pronës.

Kjo ka **pasoja të drejtpërdrejta në ekonomi familjare**, veçanërisht për gratë, të cilat shpesh nuk kanë akses të barabartë në tokë dhe pasuri të tjera, duke kufizuar mundësitë për kredi, investime dhe vetëpunësim.

Mungesa e pronësisë formale privon familjet nga burimet kryesore të të ardhurave, si toka, banesa dhe aktivitetet prodhuese, duke ushqyer **varfërinë kronike**. Formalizimi i ulët i ekonomisë rurale e rrit më tej këtë sfidë.

Prioriteti është përsheptimi i procedurave të legalizimit, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, sigurimi i transparencës dhe qasjes së barabartë, në mënyrë që të gjithë qytetarët, sidomos gratë dhe familjet vulnerabël, të mund të marrin tituj të rregullt pronësie dhe të ulet pasiguria ekonomike dhe sociale.

Dopo più di due decenni dall'avvio del processo di legalizzazione nel 2001, molte famiglie affrontano ancora **ritardi e ostacoli amministrativi** che compromettono la sicurezza giuridica della proprietà.

Questa situazione ha **conseguenze dirette sull'economia familiare**, in particolare per le donne, che spesso non hanno accesso paritario alla terra e ad altri beni, limitando le possibilità di ottenere credito, investire o avviare attività di autoimpiego.

La mancanza di titoli di proprietà formali privano le famiglie delle **principali fonti di reddito**, come terra, abitazioni e attività produttive, contribuendo a perpetuare la **povertà cronica**. Il basso livello di formalizzazione dell'economia rurale amplifica ulteriormente queste difficoltà.

La priorità consiste nel velocizzare le procedure di legalizzazione, migliorare il coordinamento tra istituzioni, garantire trasparenza e accessibilità, e assicurare che tutti i cittadini, con particolare attenzione alle donne e alle famiglie vulnerabili, possano ottenere titoli di proprietà regolari e ridurre l'insicurezza economica e sociale.

Qasja Gjinore

Pikëpamja gjinore tregon se vonesat dhe vështirësitë në legalizimin e banesave dhe pronave prekin në mënyrë disproporcionale gratë. **Mungesa e titujve të pronës** kufizon aksesin e tyre në vendimmarrje mbi menaxhimin e pasurive, zvogëlon sigurinë ekonomike dhe dobëson pozicionin e tyre brenda familjes dhe komunitetit, duke riprodhuar pabarazi gjinore dhe varësi ekonomike.

Në shumë raste, **normat tradicionale** përjashtojnë gratë dhe vajzat nga trashëgimia, edhe pse ligji garanton barazi, duke rritur cenueshmërinë e tyre ndaj dhunës dhe abuzimit.

Kjo **pabarazi strukturore** në aksesin ndaj pasurisë dhe trashëgimisë forcon nënshtrimin ekonomik dhe social të grave, duke treguar nevojën për politika të synuara që sigurojnë të drejta të barabarta, mbrojtje dhe pjesëmarrje aktive në menaxhimin e burimeve familjare.

Prospettiva di Genere

La prospettiva di genere evidenzia come i ritardi e le difficoltà nel legalizzare le abitazioni e le proprietà colpiscano in modo sproporzionato le donne. La **mancanza di titoli di proprietà** limita il loro accesso alle decisioni sulla gestione dei beni, riduce la sicurezza economica e indebolisce il loro ruolo all'interno della famiglia e della comunità, perpetuando disuguaglianze di genere e dipendenza economica.

In molte situazioni, **le norme tradizionali** escludono le donne e le ragazze dall'eredità, nonostante la legge garantisca parità, aumentando la loro vulnerabilità e rendendole più esposte a violenze e abusi.

Questa **disparità strutturale** nell'accesso alla proprietà e alla successione rafforza la subordinazione economica e sociale delle donne, evidenziando la necessità di politiche mirate per garantire diritti uguali, protezione e partecipazione attiva nella gestione delle risorse familiari.



Përsheptimi i legalizimit të banesave dhe pronave të paluajtshme

Accelerazione della legalizzazione delle abitazioni e delle proprietà immobiliari

Problemët Problemi

- Vonesa në legalizimin e shtëpive dhe pronave që nga 2001
- Pasiguri ekonomike dhe varfëri e shtuar
- Pamundësi për akses në kredi dhe subvencione
- Konfliktë pronësie dhe trashëgimie
- Mbivendosje e pronave dhe mosrespektimi i kufijve
- Ritardi nella legalizzazione delle abitazioni e delle proprietà dal 2001
- Insicurezza economica e aumento della povertà
- Impossibilità di accesso a crediti e sovvenzioni
- Conflitti di proprietà e ereditari
- Sovrapposizione delle proprietà e mancato rispetto dei confini

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Shpejtimi i proceseve të legalizimit: thjeshtimi i procedurave dhe formularëve për marrjen e pronësisë formale të shtëpive dhe tokave.
- Mbështetje ligjore dhe këshillim: ofrimi i sporteleve të asistencës ligjore për ndihmën e familjeve në legalizimin e pronës dhe zgjidhjen e konflikteve trashëgimore.
- Akses në financime dhe subvencione: zhvillimi i programeve që lejojnë familjet e legalizuara të marrin kredi, mikrokredi ose subvencione për banesa dhe aktivitete ekonomike.
- Trajnim dhe informim: fushata sensibilizuese mbi të drejtat e pronës dhe trashëgimisë, me fokus në barazinë gjinore.
- Ndërmjetësim për konflikte pronësie: krijimi i shërbimeve të ndërmjetësimit komunitar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes familjarëve mbi pronësinë dhe trashëgiminë.
- Accelerare i processi di legalizzazione: semplificare procedure e modulistica per l'ottenimento della titolarità formale di case e terreni.
- Supporto legale e consulenza: offrire sportelli di assistenza legale per aiutare le famiglie a regolarizzare la proprietà e risolvere controversie ereditarie.
- Accesso a finanziamenti e sovvenzioni: sviluppare programmi che permettano alle famiglie legalmente riconosciute di ottenere crediti, microfinanza o sovvenzioni per abitazioni e attività economiche.
- Formazione e informazione: campagne di sensibilizzazione sui diritti di proprietà e inheritance, con attenzione alla parità di genere.
- Mediazione per conflitti di proprietà: creare servizi di mediazione comunitaria per risolvere conflitti tra familiari riguardo a proprietà e eredità.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Agjencia e Legalizimit dhe Zhvillimit të Pronës
- Ministria e Drejtësisë
- Organizatat Joqeveritare të specializuara (OJF)
- Bankat dhe institucionet financiare
- Shoqatat e komunitetit lokal
- Comune di Lezhe
- Agjencia e Legalizimit dhe Zhvillimit të Pronës / Agenzia per la Legalizzazione e Sviluppo della Proprietà
- Ministria e Drejtësisë / Ministero della Giustizia
- Organizazioni non governative (ONG) specializzate
- Banche e istituzioni finanziarie
- Associazioni della comunità locale

Prioritet 1
Priorità 1



Mungesa e regjistrimit ligjor të qartë të pronave dhe monitorim i pamjaftueshëm kadastral

Mancanza di registrazione legale chiara delle proprietà e insufficiente monitoraggio catastale

Prioriteti i identifikuar lidhet me **rregullimin dhe njohjen e të drejtave të pronësisë**, veçanërisht të tokave bujqësore dhe ndërtesave pa tituj formalë, të cilat përbëjnë një nga pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Mungesa e certifikatave të pronësisë çon në përdorim joefikas të burimeve territoriale: shumë toka mbeten djerrë, të nënshfrytëzuara ose të menaxhuara në mënyrë informale, me një ndikim të drejtpërdrejtë në produktivitetin bujqësor dhe në aftësinë e komuniteteve për të zhvilluar iniciativa ekonomike lokale, si agroturizmi ose aktivitete të vogla prodhuese familiare.

Kjo situatë rrit **vulnerabilitetin ekonomik të familjeve**, kufizon aksesin në kredi dhe subvencione, dhe kontribuon në riprodhimin e varfërisë dhe përjashtimit social. Formalizimi i pronësisë nuk është vetëm një masë ligjore, por një mjet strategjik për të nxitur investime, përforcuar sigurinë ekonomike të familjeve, stimuluar zhvillimin lokal dhe promovuar një ekonomi rurale më të qartë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Qasja Gjimore

Nga perspektiva gjimore, **mungesa e dokumenteve ligjore** që garantojnë të drejtën e grave mbi tokat ose banesat kufizon thellësisht sigurinë e tyre ekonomike dhe autonominë personale.

Pa tituj ligjorë, gratë e kanë të **vështirë të marrin kredi bankare**, subvencione shtetërore ose të përfshihen në projekte zhvillimi, duke humbur mundësi reale për avancim ekonomik. Kjo gjendje i bën ato më të varura nga anëtarët meshkuj të familjes, duke rritur cenueshmërinë ndaj dhunës në familje, abuzimeve dhe diskriminimeve.

Mungesa e formalizimit të pronësisë dhe trashëgimisë mund të shkaktojë gjithashtu konflikte familjare afatgjata, që shpesh penalizojnë më shumë gratë. Të gjitha këto faktorë dobësojnë **fuqinë vendimmarrëse të grave** brenda familjes dhe komunitetit, duke penguar pjesëmarrjen e tyre të plotë në menaxhimin e burimeve dhe në vendimmarrjet lokale.

Forcimi i **të drejtave të grave për akses, përdorim dhe kontroll** mbi burimet materiale nuk është vetëm çështje drejtësie, por një mjet thelbësor për të promovuar barazi, pjesëmarrje aktive, autonomi ekonomike dhe reduktim të pabarazive gjimore.

La priorità individuata riguarda la **regolarizzazione e il riconoscimento dei diritti di proprietà**, in particolare delle terre agricole e degli immobili privi di titoli formali, che costituiscono una delle principali barriere allo sviluppo rurale sostenibile.

L'**assenza di certificati di proprietà** comporta uno sfruttamento inefficiente delle risorse territoriali: molte terre rimangono incolte, sottoutilizzate o gestite informalmente, con un impatto diretto sulla produttività agricola e sulla capacità delle comunità di sviluppare iniziative economiche locali, come l'agroturismo o piccole attività produttive.

Questa situazione aumenta la **vulnerabilità economica delle famiglie**, limita l'accesso al credito e agli incentivi pubblici, e contribuisce a perpetuare la povertà e l'esclusione sociale. La formalizzazione della proprietà non è quindi solo una misura giuridica, ma uno strumento strategico per promuovere investimenti, rafforzare la sicurezza economica delle famiglie, stimolare lo sviluppo locale e favorire un'economia rurale più trasparente e inclusiva.

Prospettiva di Genere

Dal punto di vista di genere, la **mancanza di documenti legali** che garantiscano alle donne il diritto di proprietà su terreni o abitazioni limita profondamente la loro sicurezza economica e la loro autonomia.

Senza titoli legali, le donne hanno **difficoltà ad accedere a prestiti bancari**, sovvenzioni pubbliche o progetti di sviluppo, perdendo opportunità concrete di crescita economica. Questa condizione le rende più dipendenti dai membri maschili della famiglia, aumentando la loro vulnerabilità alla violenza domestica, agli abusi e alle discriminazioni.

La **mancanza di formalizzazione delle proprietà** e delle eredità può inoltre generare conflitti familiari di lunga durata, che spesso penalizzano ulteriormente le donne. Tutto ciò riduce il **potere decisionale delle donne** sia all'interno della famiglia sia nella comunità, impedendo una piena partecipazione alla gestione delle risorse e alla definizione delle priorità locali.

Rafforzare i **diritti di accesso, uso e controllo delle donne** sulle risorse materiali non è solo una questione di giustizia, ma uno strumento fondamentale per promuovere equità, partecipazione attiva, autonomia economica e riduzione delle disuguaglianze di genere.



Mungesa e regjistrimit ligjor të qartë të pronave dhe monitorim i pamjaftueshëm kadastral

Mancanza di registrazione legale chiara delle proprietà e insufficiente monitoraggio catastale

Problemet Problemi

- Siguri ekonomike e kufizuar
- Vështirësi në aksesin në kredi dhe subvencione
- Varësi ekonomike nga anëtarët meshkuj të familjes
- Cenueshmëri më e madhe ndaj dhunës dhe abuzimeve
- Konfliktet familjare të lidhura me pronësinë dhe trashëgiminë
- Limitata siguri ekonomike
- Difficoltà di accesso a prestiti e sovvenzioni
- Dipendenza economica dai membri maschili della famiglia
- Maggiore vulnerabilità a violenza e abusi
- Conflitti familiari legati alla proprietà e all'eredità

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Regjistrimi ligjor i pronës dhe dokumentacioni për gratë
- Trajnime mbi të drejtat mbi pronësinë dhe trashëgiminë
- Akses i lehtësuar në kredi, mikrokredi dhe subvencione për gratë
- Fushata ndërgjegjësimi për barazi gjinore dhe të drejta ekonomike
- Krijimi i grupeve mbështetëse femërore për këshillim ligjor dhe financiar
- Përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse familjare dhe komunitare
- Mbështetje për projekte zhvillimi lokal të udhëhequra nga gratë
- Ndërmjetësim dhe zgjidhje e konflikteve familjare të lidhura me pronësinë
- Monitorim dhe advocacy mbi politikat publike për barazinë gjinore
- Registrazione legale di proprietà e documentazione per le donne
- Formazione su diritti di proprietà e inheritance rights
- Accesso facilitato a prestiti, microcrediti e sovvenzioni per donne
- Campagne di sensibilizzazione su parità di genere e diritti economici
- Creazione di gruppi di supporto femminili per consulenza legale e finanziaria
- Coinvolgimento delle donne nei processi decisionali familiari e comunitari
- Supporto a progetti di sviluppo locale guidati da donne
- Mediazione e risoluzione di conflitti familiari legati alla proprietà
- Monitoraggio e advocacy sulle politiche pubbliche di uguaglianza di genere

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Agjencia e Legalizimit dhe Zhvillimit të Pronës
- Ministria e Drejtësisë
- Organizatat Joqeveritare të specializuara (OJF)
- Bankat dhe institucionet financiare
- Shoqatat e komunitetit lokal
- Comune di Lezhe
- Agjencia e Legalizimit dhe Zhvillimit të Pronës / Agenzia per la Legalizzazione e Sviluppo della Proprietà
- Ministria e Drejtësisë / Ministero della Giustizia
- Organizatave non governative (ONG) specializzate
- Banche e istituzioni finanziarie
- Associazioni della comunità locale

Prioritet 2
Priorità 2



Forcimi i mbështetjes sociale për luftimin e varfërisë në zonat rurale *Rafforzamento del sostegno sociale per contrastare la povertà nelle aree rurali*

Prioriteti i identifikuar lidhet me forcimin dhe decentralizimin e mbrojtjes sociale për të luftuar varfërinë në zonat rurale, ku familjet vulnerabël përballen me ***një kombinim vështirësish ekonomike, izolimi territorial dhe akses të kufizuar në shërbime***.

Mungesa e mbështetjes sociale të strukturuar, e kombinuar me mungesën e punonjësve socialë të dedikuar dhe të lëvizshëm në fshatrat e tre Njësi Administrative, e bën të vështirë identifikimin në kohë të ***nevojave të personave më të brishtë*** dhe garantimin e vazhdimësisë së asistencës. Kjo situatë përkeqësohet më tej nga fenomeni i ***emigracionit mashkullor***, i cili lë shumë gra të vetme me fëmijët dhe rrit ndjeshëm barrën e tyre të punës së papaguar, si brenda familjes ashtu edhe në bujqësi dhe në kujdesin për të moshuarit.

Në mungesë të ***një mbështetjeje të përshtatshme institucionale***, gratë detyrohen të përballojnë përgjegjësi të shumëfishta pa rrjete mbrojtëse, me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e tyre ekonomike dhe sociale. Prandaj, forcimi i pranisë territoriale të shërbimeve sociale, përmes ekipeve të lëvizshme dhe ndërhyrjeve të afërsisë, është thelbësor për të ulur varfërinë, përmirësuar aksesin në masat mbështetëse dhe promovuar rrugë më të drejta dhe efektive të përfshirjes sociale në zonat rurale.

Qasja Gjinore

Kjo problematikë ka një dimension të qartë gjinor, pasi prek në mënyrë disproporcionale ***gratë dhe vajzat*** në zonat rurale. Në mungesë të një asistence sociale të përshtatshme, shumë gra përballen me ***vështirësi serioze në aksesin në të ardhura, shërbime bazë dhe masa mbrojtëse***, me pasoja të drejtpërdrejta mbi autonominë e tyre ekonomike dhe aftësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse në nivel familjar dhe komunitar.

Mungesa e punonjësve socialë të lëvizshëm penalizon veçanërisht ***gratë rurale***, të cilat më shpesh jetojnë në kushte varfërie, izolimi dhe dhune, situata që shpesh nuk identifikohen nga shërbimet institucionale. Gratë kryefamiljare, gratë e moshuara dhe ato me aftësi të kufizuara përbëjnë ndër kategoritë më të ekspozuara, me akses shumë të kufizuar në shërbime sociale dhe në informacion mbi të drejtat e tyre.

Ky ***boshllëk në mbrojtjen sociale*** kontribuon në riprodhimin dhe forcimin e pabarazive gjinore, duke lënë shumë gra pa mbështetje në momentet e tyre më të cenueshme dhe duke rritur rrezikun e përjashtimit social dhe të mungesës së mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore.

La priorità individuata riguarda il rafforzamento della protezione sociale per contrastare la povertà nelle aree rurali, dove le famiglie vulnerabili affrontano una ***combinazione di difficoltà economiche, isolamento territoriale e accesso limitato ai servizi***.

La carenza di sostegno sociale strutturato, unita all'assenza di operatori sociali dedicati e mobili nei villaggi, rende difficile intercettare tempestivamente ***i bisogni delle persone più fragili*** e garantire continuità nell'assistenza. Questa situazione è ulteriormente aggravata dal fenomeno dell'***emigrazione maschile***, che lascia molte donne sole con i figli e aumenta in modo significativo il loro carico di lavoro non retribuito, sia all'interno della famiglia sia nelle attività agricole e nella cura degli anziani.

In assenza di ***adeguato supporto istituzionale***, le donne si trovano a sostenere responsabilità multiple senza reti di protezione, con un impatto diretto sul loro benessere economico e sociale. Rafforzare la presenza territoriale dei servizi sociali, attraverso équipe mobili e interventi di prossimità, è quindi essenziale per ridurre la povertà, migliorare l'accesso alle misure di sostegno e promuovere percorsi di inclusione sociale più equi ed efficaci nelle aree rurali.

Prospettiva di Genere

La problematica assume una chiara dimensione di genere, poiché colpisce in modo sproporzionato le ***donne e le ragazze*** nelle aree rurali. In assenza di un'adeguata assistenza sociale, molte donne incontrano ***gravi difficoltà nell'accesso a reddito, servizi di base e misure di protezione***, con effetti diretti sulla loro autonomia economica e sulla capacità di partecipare attivamente ai processi decisionali a livello familiare e comunitario.

La mancanza di operatori sociali mobili penalizza in particolare ***le donne rurali***, che più frequentemente vivono situazioni di povertà, isolamento e violenza, spesso non intercettate dai servizi istituzionali. Le donne capofamiglia, le donne anziane e quelle con disabilità risultano tra le categorie più esposte, con un accesso fortemente limitato ai servizi sociali e alle informazioni sui propri diritti.

Questo ***vuoto di protezione*** contribuisce a riprodurre e rafforzare le disuguaglianze di genere, lasciando molte donne senza supporto nei momenti di maggiore vulnerabilità e aumentando il rischio di esclusione sociale e di mancata tutela dei loro diritti fondamentali.



Forcimi i mbështetjes sociale për luftimin e varfërisë në zonat rurale

Rafforzamento del sostegno sociale per contrastare la povertà nelle aree rurali

Problemët Problemi

- Varfëria dhe mbështetja sociale e kufizuar .
- Mungesa e punonjësve të dedikuar socialë të lëvizshëm për fshatrat në zonat rurale të njësive administrative.
- Povertà e supporto sociale limitato.
- Mancanza di operatori sociali dedicati e mobili per i villaggi nelle aree rurali delle unità amministrative.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Zbatimi programe lokale të punësimit dhe vetëpunësimit, në bashkëpunim me bizneset lokale, agroturizmin dhe bujqësinë, me fokus te familjet në nevojë.
- Zbatimi i projekteve sociale të integruara, në partneritet me OJF-të dhe donatorët.
- Krijimi i një shërbimi social të lëvizshëm të përhershëm, me punonjës socialë të punësuar nga bashkia, të pajisur me mjete logjistike dhe me një plan të rregullt vizitash në fshatra.
- Integrimi i shërbimeve sociale me shëndetësinë dhe arsimin, përmes ekipeve multidisciplinare në terren.
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe forcimi i kapaciteteve institucionale, duke përfshirë shërbimin social të lëvizshëm në buxhetin vjetor të bashkisë dhe në planet afatmesme.
- Attuazione di programmi locali di occupazione e autoimpiego, in collaborazione con le imprese locali, l'agriturismo e l'agricoltura, con focus sulle famiglie in difficoltà.
- Implementazione di progetti sociali integrati, in partenariato con ONG e donatori.
- Istituzione di un servizio sociale mobile permanente, con assistenti sociali assunti dal Comune, dotati di mezzi logistici e di un piano regolare di visite nei villaggi.
- Integrazione dei servizi sociali con sanità e istruzione, mediante équipe multidisciplinari sul territorio
- Garanzia di finanziamenti stabili e rafforzamento delle capacità istituzionali, includendo il servizio sociale mobile nel bilancio comunale e nei piani a medio termine

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhër
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Qendra Shëndetësore të Njësive Administrative
- Shoqata të ndryshme
- Comune di Lezhe
- Ministero della Salute e della Protezione Sociale (MSHMS)
- Centri sanitari delle unità amministrative
- Associazioni

Prioritet 3
Priorità 3



Zgjerimi i shërbimeve të mbështetjes dhe përfshirjes për personat me nevoja të veçanta *Ampliamento dei servizi di supporto e inclusione per le persone con bisogni speciali*

Pamjaftueshmëria e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta përbën një nga sfidat më të mëdha sociale në nivel vendor, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës, autonominë dhe përfshirjen e tyre në komunitet.

Aktualisht, mungesa e shërbimeve të specializuara, si qendrat ditore, shërbimet rehabilituese dhe strukturat rezidenciale, kufizon rëndë aksesin e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në **mbështetje të vazhdueshme dhe cilësore**. Kjo situatë rëndohet nga **kapacitetet e pamjaftueshme** të stafit vendor dhe të institucioneve arsimore e shëndetësore për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse, si dhe nga **infrastruktura publike ende pak e aksesueshme**, që pengon pjesëmarrjen aktive në jetën sociale dhe ekonomike.

Numri i lartë i **kërkesave për shërbime rezidenciale** tregon qartë nevojën urgjente për hapjen e një qendre të tillë në nivel bashkie. Përballë këtyre sfidave, bëhet e domosdoshme zgjerimi dhe forcimi i shërbimeve sociale të specializuara, investimi në ndërtimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimi i aksesueshmërisë publike, për të garantuar të drejta të barabarta, dinjitet dhe përfshirje reale për personat me aftësi ndryshe.

Qasja Gjinore

Nga perspektiva gjinore, pamjaftueshmëria e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta prodhon **pasoja disproporcionale për gratë** dhe vajzat, duke përforcuar pabarazitë ekzistuese. Në mungesë të shërbimeve sociale, rehabilituese dhe të shëndetit mendor të përshtatshme, barra e kujdesit bie pothuajse tërësisht mbi gratë, të cilat marrin rolin kryesor të kujdestareve në familje.

Kjo kufizon ndjeshëm mundësitë e tyre për punësim të paguar, sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme dhe aksesin në shërbime bazë, duke ulur pavarësinë ekonomike dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe në vendimmarrje.

Njëkohësisht, mungesa e shërbimeve për shëndetin mendor prek veçanërisht gratë dhe vajzat, të cilat janë më të ekspozuara ndaj **stresit, ankthit, dhunës dhe ngarkesës së lartë emocionale** që lidhet me përgjegjësitë e kujdesit. Në këtë kontekst, mungesa e shërbimeve gjithëpërfshirëse nuk është vetëm një problem social, por një **faktor strukturor që riprodhon pabarazitë gjinore**, duke e bërë të domosdoshëm integrimin sistematik të qasjes gjinore në projektimin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta.

L'insufficienza dei servizi per le persone con bisogni speciali rappresenta una delle principali criticità sociali a livello locale, con un impatto diretto sulla qualità della vita, sull'autonomia e sull'inclusione sociale delle persone con disabilità.

Attualmente, la carenza di servizi specializzati, come centri diurni, servizi riabilitativi e strutture residenziali, limita fortemente l'accesso a un **sostegno continuativo e adeguato**, sia per le persone interessate sia per le loro famiglie. Questa situazione è aggravata dalle **capacità ancora insufficienti** del personale degli enti locali e delle istituzioni educative e sanitarie nel fornire servizi realmente inclusivi, nonché da un'**infrastruttura pubblica poco accessibile**, che ostacola la piena partecipazione alla vita sociale ed economica.

L'elevato numero di **richieste di accoglienza residenziale** evidenzia in modo chiaro l'urgenza di aprire una struttura dedicata a livello comunale. Di fronte a queste sfide, diventa prioritario ampliare e rafforzare i servizi sociali specializzati, investire nella formazione continua degli operatori e migliorare l'accessibilità degli spazi e dei servizi pubblici, al fine di garantire pari diritti, dignità e una reale inclusione delle persone con disabilità.

Prospettiva di Genere

Dal punto di vista di genere, l'insufficienza dei servizi per le persone con bisogni speciali produce **effetti sproporzionati sulle donne** e sulle ragazze, rafforzando dinamiche di disuguaglianza già esistenti. In assenza di servizi sociali, riabilitativi e di salute mentale adeguati, il **carico di cura ricade quasi esclusivamente sulle donne**, che assumono il ruolo di caregiver principali all'interno della famiglia.

Questo limita fortemente la loro possibilità di accedere a un lavoro retribuito, di garantire un reddito stabile e di usufruire dei servizi di base, riducendo l'autonomia economica e la partecipazione attiva alla vita sociale e ai processi decisionali.

Allo stesso tempo, la carenza di servizi di supporto alla salute mentale colpisce in modo particolare donne e ragazze, più esposte a **stress cronico, ansia, violenza e sovraccarico emotivo** legato alle responsabilità di cura. In questo contesto, la mancanza di servizi inclusivi non è solo una problematica sociale, ma un **fattore strutturale che riproduce le disuguaglianze di genere**, rendendo indispensabile un approccio che integri sistematicamente la prospettiva di genere nella progettazione e nell'erogazione dei servizi per le persone con bisogni speciali.



Zgjerimi i shërbimeve të mbështetjes dhe përfshirjes për personat me nevoja të veçanta

Ampliamento dei servizi di supporto e inclusione per le persone con bisogni speciali

Problemët Problemi

- Pamjaftueshmëri të shërbimeve për persona me nevoja të veçanta.
- Kapacitete të kufizuara institucionale dhe profesionale.
- Pengesa fizike dhe mungesë aksesueshmërie në hapësirat publike.
- Mungesë e strukturave rezidenciale të specializuara.
- Insuficienza di servizi sociali per persone con disabilità.
- Limitata capacità istituzionale e professionale.
- Barriere fisiche e scarsa accessibilità degli spazi pubblici.
- Mancanza di strutture residenziali adeguate.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Zgjerimi dhe forcimi i shërbimeve sociale të specializuara, përmes krijimit të qendrave ditore dhe shërbimeve rehabilituese në nivel bashkie dhe njësisë administrative, për të garantuar akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara.
- Ndërtimi i kapaciteteve të stafit vendor dhe institucioneve arsimore/shëndetësore, përmes trajnimeve të vazhdueshme mbi përfshirjen, shërbimet gjithëpërfshirëse dhe standardet e aksesueshmërisë.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe aksesueshmërisë publike, duke përshtatur ndërtesat, transportin dhe hapësirat publike sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Hapja e një qendre rezidenciale për persona me aftësi ndryshe sepse ka shumë kërkesa.
- Espansione e rafforzamento dei servizi sociali specializzati, attraverso la creazione di centri diurni e servizi riabilitativi a livello comunale e delle unità amministrative, per garantire un accesso equo alle persone con disabilità.
- Sviluppo delle capacità del personale locale e delle istituzioni educative/sanitarie, tramite formazione continua sull'inclusione, servizi integrati e standard di accessibilità.
- Miglioramento dell'infrastruttura e dell'accessibilità pubblica, adattando edifici, trasporti e spazi pubblici alle esigenze delle persone con disabilità, in conformità con gli standard nazionali e internazionali.
- Apertura di un centro residenziale per persone con abilità diverse, vista l'alta domanda.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Qendra Shëndetësore të Njësive Administrative
- Shoqata të ndryshme
- Comune di Lezhe
- Ministero della Salute e della Protezione Sociale (MSHMS)
- Centri sanitari delle unità amministrative
- Associazioni

Prioritet 4
Priorità 4



Parandalimi i dhunës dhe diskriminimeve gjinore

Contrasto alla violenza e alle discriminazioni di genere

Në zonat rurale, **dhuna me bazë gjinore mbetet shpesh e fshehur** për shkak të izolimit të grave, mungesës së hapësirave komunitare dhe aktiviteteve sociale, si dhe normave patriarkale që kufizojnë pjesëmarrjen e tyre publike. Raportimi i rasteve të dhunës në familje është minimal, veçanërisht në familjet tradicionale, dhe fushatat sensibilizuese janë të pamjaftueshme.

Mungesa e shërbimeve informative të vazhdueshme për të rinjtë, nxënësit dhe komunitetin mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, femicidin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, së bashku me **mungesën e strehëzave** të përshtatshme, rrit rrezikun për viktimat dhe çon në njohje të pakët të formave të dhunës, **normalizim** të saj dhe raportim minimal të rasteve, sidomos nga gratë dhe vajzat. Kjo situatë forcon stereotipet gjinore dhe rrit **tolerancën ndaj dhunës**, duke kufizuar aftësinë e të rinjve dhe komunitetit për ta parandaluar dhe adresuar atë.

Është urgjente të forcohen linjat e mbështetjes së dedikuar, të krijohen stacione ndihme dhe strehëza për viktimat, të zgjerohet stafi social i lëvizshëm në Njësitë Administrative dhe të ofrohen seanca edukative mbi kujdesin për fëmijët dhe informacion paramartesor, për të përmirësuar parandalimin, mbrojtjen dhe përfshirjen në komunitetet rurale.

Qasja Gjinore

Dhuna me bazë gjinore në zonat rurale ka një dimension të qartë gjinor, duke goditur në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat.

Mungesa e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere mbi format e ndryshme të dhunës çon në njohje të pamjaftueshme të fenomenit, **normalizim të tij dhe mosraportim** të rasteve, sidomos nga gratë.

Mungesa e strehëzave dhe hapësirave të sigurta detyron shumë gra viktima të dhunës në familje të qëndrojnë në **mjedise të pasigurta** ose të kthehen te dhunuesi, duke rritur varësinë ekonomike dhe rrezikun e dhunës së përsëritur.

Kjo situatë forcon stereotipet gjinore, kufizon aftësinë e grave për vetëvendosje dhe përkeqëson pabarazitë në qasje ndaj mbrojtjes, sigurisë dhe shërbimeve mbështetëse.

Nelle aree rurali, la **violenza di genere resta spesso nascosta** a causa dell'isolamento delle donne, della scarsità di spazi comunitari e attività sociali, e di norme patriarcali che limitano la loro partecipazione pubblica.

Il reporting di episodi di violenza familiare è minimo, soprattutto nelle famiglie tradizionali, e le campagne di sensibilizzazione risultano insufficienti.

La **manca di servizi informativi continui** rivolti a giovani, studenti e comunità su tutte le forme di violenza di genere, inclusa la violenza domestica, il femicidio e la tratta, insieme all'**assenza di rifugi** adeguati, incrementa il rischio per le vittime e porta a una scarsa conoscenza delle sue forme, alla **normalizzazione della violenza** e alla sottosegnalazione dei casi, soprattutto da parte di donne e ragazze. Questa situazione rafforza gli stereotipi di genere e aumenta la **toleranza verso la violenza**, limitando la capacità dei giovani e della comunità di prevenirla e affrontarla.

È quindi urgente potenziare linee di supporto dedicate, creare stazioni di assistenza e rifugi per le vittime, ampliare il personale sociale mobile nelle Njësitë Administrative e offrire sessioni educative su prendersi cura dei figli e informazione prematrimoniale, per migliorare prevenzione, protezione e inclusione nelle comunità rurali.

Prospettiva di Genere

La **violenza di genere** nelle aree rurali assume una chiara dimensione di genere, colpendo in modo sproporzionato donne e ragazze.

La mancanza di attività informative e di sensibilizzazione sulle diverse forme di violenza porta a una scarsa conoscenza del fenomeno, alla sua **normalizzazione e a una sottosegnalazione** dei casi, soprattutto da parte delle donne.

L'assenza di rifugi e spazi sicuri costringe molte donne vittime di violenza domestica a rimanere in **contesti pericolosi** o a tornare dai propri aggressori, aumentando la dipendenza economica e il rischio di violenza ripetuta.

Questa situazione rafforza stereotipi di genere, limita la capacità di autodeterminazione delle donne e peggiora le disuguaglianze nell'accesso a protezione, sicurezza e servizi di supporto.



Parandalimi i dhunës dhe diskriminimeve gjinore

Contrasto alla violenza e alle discriminazioni di genere

Problemët Problemi

- Mungesa e aktivitete informuese dhe ndërgjegjëse me nxënëse/nxënës, të rejtat/të rinjtë dhe komunitetin në tërësi, mbi format e ndryshme të dhunës me baze gjinore
- Mungesë e strehëzave për viktimat e dhunës në familje.
- Mancanza di attività informative e di sensibilizzazione con studentesse/studenti, giovani e la comunità nel suo insieme, sulle diverse forme di violenza di genere.
- Mancanza di rifugi per le vittime di violenza domestica.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Fushata ndërgjegjëse komunitare: aktivitete të rregullta në qendra komunitare, njësitë administrative dhe media lokale,
- Bashkëpunim me shoqata dhe institucione: programe të qëndrueshme informuese, trajnim “peer-to-peer” dhe aktivitete edukative për parandalimin e dhunës
- Krijimi i strehëzave bashkiake të përhershme: struktura të sigurt për emergjencë dhe periudha të përkohshme për viktimat dhe fëmijët
- Model i integruar shërbimesh në strehëza: përfshin mbështetje psikosociale, ndihmë ligjore, shërbime shëndetësore dhe programe riintegrimi ekonomik
- Partneritete të qëndrueshme me OJF-të e specializuara: menaxhim dhe financim afatgjatë i strehëzave dhe referim efektiv i rasteve nga strukturat vendore.
- Campagne comunitarie di sensibilizzazione: attività regolari in centri comunitari, unità amministrative e media locali,
- Collaborazioni con associazioni e istituzioni: programmi sostenibili di informazione, formazione peer-to-peer e attività educative per prevenire la violenza di genere
- Creazione di rifugi municipali permanenti: strutture in collaborazione con ministeri e donatori, per garantire accoglienza d'emergenza e temporanea a vittime e figli.
- Modello integrato di servizi nei rifugi: supporto psicossociale, assistenza legale, servizi sanitari e programmi di reinserimento economico per le vittime.
- Partnership sostenibili con ONG specializzate: gestione e finanziamento stabile dei rifugi e riferimento efficace dei casi dalle strutture locali.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Qendrat Komunitare të NJA
- Shkollat e këtyre njësive administrative
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Shoqata të ndryshme
- Comune di Lezhe
- Centri Comunitari delle Unità amministrative
- Scuole delle Unità
- Ministero della Salute e della Protezione Sociale (MSHMS)
- Associazioni

Prioritet 5
Priorità 5



Përmirësimin e infrastrukturës bazë në zonat rurale

Miglioramento dell'infrastruttura di base nelle aree rurali

Prioriteti i infrastrukturës në Njësitë Administrative Rrethina, Postribë dhe Gur i Zi përqendrohet në përmirësimin dhe zgjerimin e **infrastrukturës esenciale** në dobi të komuniteteve rurale.

Aktualisht, **shumë zona janë pa infrastrukturë** sportive, kënde lojërash të sigurt për fëmijët, rrugë të asfaltuara, sisteme të besueshme furnizimi me ujë, rrjete kanalizimesh dhe ndriçim publik adekuat. Kjo **mungesë shërbimesh esenciale** kufizon aksesin në arsim, shëndetësi, punë dhe aktivitete rekreative, rrit rreziqet për sigurinë dhe ul cilësinë e jetës.

Gratë dhe vajzat, të cilat shpesh përballen me kufizime kulturore dhe detyra shtëpiake, preken në mënyrë të veçantë, po ashtu fëmijët dhe të rinjtë, të cilët përfundojnë pengesa në zhvillimin fizik, social dhe emocional për shkak të mungesës së hapësirave të përshtatshme. Ndërhryjet e synuara duhet të kombinojnë **ndërtimin dhe rikualifikimin** e infrastrukturës me strategji **mirëmbajtjeje të qëndrueshme**, duke përfshirë aktivisht komunitetin, institucionet lokale dhe donatorët potencialë, për të reduktuar pabarazitë territoriale dhe gjinore dhe për të bërë zonat rurale më të sigurt, të banueshme dhe tërheqëse.

Qasja Gjinore

Perspektiva gjinore evidenton se **mungesa e infrastrukturave thelbësore** në zonat rurale, duke përfshirë rrugët e pa asfaltuara, mungesën e ujit të pijshëm, ndriçimin publik të pamjaftueshëm, mungesën e hapësirave sportive dhe këndeve të lojës, ndikon në mënyrë disproporcionale tek gratë, vajzat dhe fëmijët.

Gratë dhe vajzat përballen me rreziqe më të larta për sigurinë, kufizime në lëvizje për punë, arsim dhe akses në shërbime, si dhe barrë më të madhe të përgjegjësisë shtëpiake dhe kujdesit të papaguar.

Mungesa e hapësirave të sigurt për socializim dhe aktivitete fizik kufizon zhvillimin social, emocional dhe fizik të fëmijëve, duke forcuar pabarazitë gjinore që në moshë të hershme.

Integrimi i perspektivës gjinore në **planifikimin dhe realizimin e infrastrukturës** nënkupton krijimin e ndërhyrjeve që garantojnë akses të barabartë, siguri dhe mundësi pjesëmarrjeje për të gjithë anëtarët e komunitetit, me fokus të veçantë tek grupet më vulnerabel.

La priorità infrastrutturale nelle unità amministrative Rrethina, Postribë e Gur i Zi si concentra sul miglioramento e l'ampliamento delle **infrastrutture essenziali** a beneficio della comunità rurale.

Attualmente, **molte aree sono prive di strutture** sportive, aree gioco sicure per i bambini, strade asfaltate, sistemi di approvvigionamento idrico affidabili, reti fognarie e illuminazione pubblica adeguata. Questa **carenza di servizi essenziali** limita l'accesso a istruzione, salute, lavoro e attività ricreative, aumentando i rischi per la sicurezza e riducendo la qualità della vita.

Le **donne** e le **ragazze**, che spesso affrontano vincoli culturali e responsabilità domestiche, sono particolarmente colpite, così come bambini e giovani, la cui crescita fisica, sociale ed emotiva è compromessa dalla mancanza di spazi adeguati. Interventi mirati devono quindi combinare la **costruzione** e la **riqualificazione** delle infrastrutture con strategie di **manutenzione sostenibile**, coinvolgendo attivamente comunità, istituzioni locali e potenziali donatori, al fine di ridurre le disuguaglianze territoriali e di genere e rendere le aree rurali più sicure, vivibili e attrattive.

Prospettiva di Genere

La prospettiva di genere evidenzia come la **carenza di infrastrutture essenziali** nelle aree rurali, comprese strade non asfaltate, mancanza di acqua potabile, insufficiente illuminazione pubblica, assenza di spazi sportivi e aree gioco, colpisca in modo sproporzionato le donne, le ragazze e i bambini.

Le **donne** e le **ragazze** affrontano maggiori rischi per la sicurezza, limitazioni negli spostamenti per lavoro, istruzione e accesso ai servizi, e un carico maggiore di responsabilità domestiche e di cura non retribuita.

L'**assenza di spazi sicuri** per la socializzazione e l'attività fisica limita lo sviluppo sociale, emotivo e fisico dei bambini, rafforzando disuguaglianze di genere fin dalla giovane età.

Integrare una prospettiva di genere nella **pianificazione e realizzazione delle infrastrutture** significa progettare interventi che garantiscano accesso equo, sicurezza, e opportunità di partecipazione per tutti i membri della comunità, con particolare attenzione ai gruppi più vulnerabili.



Përmirësimin e infrastrukturës bazë në zonat rurale të Rrethina, Postribë dhe Gur i Zi Miglioramento dell'infrastruttura di base nelle aree rurali di Rrethina, Postribë e Gur i Zi

Problemët Problemi

- Mungesa e infrastrukturës sportive dhe këndeve të sigurta për lojë
- Mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm
- Mungesa e rrjetit të kanalizimeve dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza
- Rugë të pa asfaltuara dhe vështirësi në qasje
- Mungesa e ndriçimit publik në zonat e banuara
- Pabarazi territoriale midis zonave urbane dhe rurale
- Mancanza di infrastrutture sportive e aree gioco sicure
- Approvvigionamento idrico inaffidabile
- Assenza di reti fognarie e sistemi di smaltimento acque reflue
- Strade non asfaltate e difficoltà di accesso
- Mancanza di illuminazione pubblica nelle zone abitate
- Inequità territoriale tra aree urbane e rurali

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara dhe itinerareve të sigurta për të garantuar lëvizjen dhe aksesin në shërbime bazë.
- Vendosja e impianteve të ndriçimit publik, kryesisht LED ose solare, në zonat e banuara dhe rrugët kryesore.
- Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujit të pijshëm, me monitorim të humbjeve dhe përfshirje të komunitetit në menaxhimin e shërbimit.
- Krijimi ose përmirësimi i sistemeve të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza për uljen e rreziqeve shëndetësore dhe mjedisore.
- Krijimi i hapësirave sportive dhe këndeve të lojërave të sigurta dhe multifunkionale në fshatra, të integruara me shkolla dhe qendra komunitare.
- Përfshirja e komunitetit lokal në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e hapësirave publike për të garantuar siguri dhe qëndrueshmëri.
- Costruzione e manutenzione di strade asfaltate e percorsi sicuri per garantire mobilità e accesso a servizi essenziali.
- Installazione di impianti di illuminazione pubblica, preferibilmente LED o solare, nelle aree residenziali e lungo le strade principali.
- Realizzazione e riqualificazione di reti di acqua potabile con monitoraggio delle perdite e gestione partecipativa del servizio.
- Costruzione o miglioramento di sistemi di fognatura e depurazione dei reflui per ridurre rischi sanitari e ambientali.
- Creazione di spazi sportivi e aree gioco sicure e multifunzionali nei villaggi, integrate con scuole e centri comunitari.
- Coinvolgimento della comunità locale nella gestione, manutenzione e sorveglianza degli spazi pubblici per garantirne sicurezza e sostenibilità.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Infrastrukturës
- Sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lezhë
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Shkollat dhe qendrat komunitare lokale
- Donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë
- Komuniteti lokal dhe prindërit
- Shoqatat sportive dhe kulturore
- Bashkia di Lezhe
- Ministero dell'Istruzione e dello Sport
- Ministero delle Infrastrutture
- Sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lezhë
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Scuole e centri comunitari locali
- Donatori nazionali e internazionali
- Comunità locali e genitori
- Associazioni sportive e culturali

Prioritet 6
Priorità 6



Akses i barabartë dhe cilësor në shërbimet arsimore në zonat rurale

Accesso equo e di qualità ai servizi scolastici nelle aree rurali

Prioriteti i identifikuar lidhet me përmirësimin e **aksesit të barabartë dhe të cilësisë së shërbimeve arsimore** dhe psiko-edukative në zonat rurale, me vëmendje të veçantë ndaj vajzave dhe grave, me një fokus të veçantë në zonën e Dajçit.

Mangësitë strukturore të sistemit arsimor, mungesa e personelit të specializuar dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse ndikojnë negativisht në vazhdimësinë e arsimit, duke nxitur **braktisjen e hershme shkollore** dhe duke kufizuar mundësitë për zhvillim personal dhe profesional.

Këto problematika prekin në mënyrë disproporcionale **vajzat, të cilat shpesh ndërpresin shkollimin** për të marrë përgjegjësi familjare dhe kujdestarie, duke përforcuar ciklet e pabarazisë gjinore dhe territoriale.

Forcimi i shërbimeve arsimore dhe psiko-sociale, veçanërisht **në komunitetet më të izoluar**, është thelbësor për të garantuar mundësi të barabarta, për të promovuar përfshirjen dhe për të mbështetur një pjesëmarrje më aktive të grave në arsim, në punësim dhe në jetën shoqërore.

Qasja Gjinore

Pabarazitë arsimore në zonat rurale nuk janë neutrale, por prekin në mënyrë disproporcionale vajzat dhe gratë përgjatë gjithë rrugëtimit arsimor dhe kufizojnë veçanërisht aftësinë e vajzave për të përballuar presionin social, stereotipet gjinore, diskriminimin dhe, në disa raste, format e dhunës, duke ndikuar negativisht në **mirëqenien emocionale** dhe vetëbesimin.

Klasat e bashkuara dhe pamundësia për të ofruar mësim të përshtatur për nevojat individuale i thellojnë këto cenueshmëri, duke rritur rrezikun e **demotivimit dhe braktisjes së hershme shkollore**.

Paralelisht, mungesa e **shërbimeve për fëmijërinë e hershme**, si çerdhet, përforcon ndarjen tradicionale të roleve të kujdesit, duke rënduar kryesisht mbi gratë dhe duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe në arsimin e vazhduar, me pasoja të tërthorta por domethënëse edhe për mundësitë arsimore të vajzave.

Së fundi, **vështirësitë në aksesin në arsimin e mesëm**, për shkak të distancës gjeografike dhe kostove të transportit, ndikojnë më shumë tek vajzat, të cilat më shpesh ndërpresin arsimin pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

La priorità individuata riguarda il miglioramento dell'**accesso equo e della qualità dei servizi educativi** e di supporto psico-educativo nelle aree rurali, con particolare attenzione alle ragazze e alle donne, con particolare riferimento alla zona di Dajç.

Le **carenze strutturali** del sistema educativo, la mancanza di personale specializzato e l'assenza di servizi di supporto incidono negativamente sulla continuità dei percorsi scolastici, favorendo **l'abbandono precoce** e limitando le opportunità di sviluppo personale e professionale.

Queste criticità colpiscono in modo sproporzionato **le ragazze, che spesso interrompono gli studi** per assumere responsabilità familiari e di cura, rafforzando cicli di disuguaglianza di genere e territoriale.

Rafforzare i servizi educativi e psico-sociali, soprattutto nelle **comunità più isolate**, è quindi essenziale per garantire pari opportunità, promuovere l'inclusione e sostenere una partecipazione femminile più attiva all'istruzione, al lavoro e alla vita sociale.

Prospettiva di Genere

Le **disuguaglianze educative** nei contesti rurali non siano neutre, ma colpiscano in modo sproporzionato le ragazze e le donne lungo l'intero percorso formativo e limitano in particolare la capacità delle ragazze di affrontare pressioni sociali, stereotipi di genere, discriminazioni e, in alcuni casi, forme di violenza, con ricadute negative sul **benessere emotivo**, sull'autostima e sul rendimento scolastico.

Le classi unite e la difficoltà di offrire un insegnamento personalizzato accentuano tali vulnerabilità, aumentando il rischio di **demotivazione e abbandono scolastico** precoce.

Parallelamente, la mancanza di servizi per la prima infanzia, come le strutture per **l'educazione prescolare**, rafforza la divisione tradizionale dei ruoli di cura, ricadendo prevalentemente sulle donne e limitando la loro partecipazione al mercato del lavoro e alla formazione continua, con effetti indiretti ma significativi anche sulle opportunità educative delle figlie.

Infine, le **difficoltà di accesso all'istruzione secondaria**, dovute alla distanza geografica e ai costi di trasporto, incidono in misura maggiore sulle ragazze, che più frequentemente interrompono il percorso di studi dopo l'istruzione obbligatoria.



Akses i barabartë dhe cilësor në shërbimet arsimore në zonat rurale

Accesso equo e di qualità ai servizi scolastici nelle aree rurali

Problemët Problemi

- Cilësi e ulët e kushteve mësimore dhe infrastrukturë në shkollën e Dajçit.
- Klasat e bashkuara dhe rënia e cilësisë së mësimdhënies
- Mungesa e shërbimeve për fëmijërinë e hershme (çerdhe)
- Braktisja e shkollimit të vajzave pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm
- Baza e ulët e kushteve didaktike e infrastrukturale në shkollën e Dajçit.
- Classi combinate e il calo della qualità dell'insegnamento
- Assenza di servizi per la prima infanzia (çerdhe)
- Abbandono scolastico delle ragazze dopo l'istruzione obbligatoria

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Rikonstruksion i godinës (klasa, tualete, sistem ngrohjeje, izolim termik)
- Pajisje me laboratorë dhe mjete digjitale mësimore
- Përmirësim i ambienteve sportive dhe hapësirave ndihmëse
- Hartimi i një plani vjetor mirëmbajtjeje
- Trajnim i vazhdueshëm për mësuesit
- Krijimi i partneriteteve me donatorë dhe komunitetin
- Pasurimi i bazës didaktike dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare
- Ristrutturazione dell'edificio (aule, servizi igienici, sistema di riscaldamento, isolamento termico)
- Dotazione di laboratori e strumenti digitali per l'apprendimento
- Miglioramento degli ambienti sportivi e degli spazi di supporto
- Definizione di un piano annuale di manutenzione
- Formazione continua per gli insegnanti
- Attivazione di partenariati con donatori e comunità
- Arricchimento della dotazione didattica e delle attività extracurricolari

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Bashkia Lezhë
- Shkollat lokale
- Qendrat komunitare
- Psikologët dhe stafi psiko-social
- Donatorë dhe OJF vendore dhe ndërkombëtare
- Familjet dhe komuniteti
- Ministero dell'Istruzione e dello Sport
- Bashkia Lezhë
- Scuole locali
- Centri comunitari
- Psicologi e personale psico-sociale
- Donatori e ONG locali e internazionali
- Famiglie e comunità

Prioritet 7
Priorità 7



Forcimi i infrastrukturës dhe shërbimeve bujqësore *Rafforzamento delle infrastrutture e dei servizi agricoli*

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit bujqësor në njësitë administrative të analizuara kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga **cilësia** dhe **funksionaliteti i infrastrukturave bazë**, veçanërisht i sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

Aktualisht, shumë prej këtyre infrastrukturave janë të **amortizuara, të dëmtuara ose të pamjaftueshme** në raport me nevojat reale të fermerëve, duke sjellë humbje në prodhim, përdorim joefikas të burimeve ujore dhe rritje të ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Në një kontekst ku bujqësia përbën një nga burimet kryesore të të ardhurave, **mungesa e sistemeve të besueshme të ujitjes** kufizon jo vetëm sasinë, por edhe cilësinë e prodhimit, duke ulur konkurrueshmërinë e produkteve vendase.

Për më tepër, **mungesa e një menaxhimi të koordinuar** të burimeve ujore dhe e planeve sistematike të mirëmbajtjes e përkeqëson situatën.

Ndërhyrjet në këtë drejtim janë thelbësore jo vetëm për rritjen e prodhimit, por edhe për krijimin e kushteve për një **zhvillim rural më të balancuar**, më rezistent dhe më tërheqës për investime në afat të mesëm dhe të gjatë.

Qasja Gjinore

Nga këndvështrimi i qasjes gjinore, **përmirësimi i infrastrukturave bujqësore** ka një rol kyç në reduktimin e pabarazive midis burrave dhe grave në zonat rurale.

Gratë, të cilat shpesh **mbajnë përgjegjësinë kryesore** për menaxhimin e aktiviteteve bujqësore familjare, janë ndër më të prekura nga mungesa e ujit dhe nga sistemet joefikase të ujitjes, duke përballuar një ngarkesë më të madhe fizike dhe organizative.

Mungesa e aksesit të barabartë në burimet prodhuese kufizon aftësinë e tyre për të planifikuar, investuar dhe inovuar.

Sigurimi i **infrastrukturave funksionale** dhe të aksesueshme kontribuon jo vetëm në rritjen e prodhimit, por edhe në **përmirësimin konkret të kushteve të punës** së grave, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje dhe forcimin e rolit të tyre ekonomik në komunitet.

Një qasje gjithëpërfshirëse kërkon përfshirjen aktive të grave në planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e këtyre ndërhyrjeve.

Lo sviluppo sostenibile del settore agricolo nelle unità amministrative analizzate è fortemente condizionato dalla **qualità** e dalla **funzionalità** delle **infrastrutture di base**, in particolare dei sistemi di irrigazione e drenaggio.

Attualmente, molte di queste infrastrutture risultano **obsolete, danneggiate o insufficienti** rispetto ai bisogni reali dei produttori locali, con conseguenti perdite di produttività, inefficienze nell'uso delle risorse idriche e maggiore vulnerabilità agli shock climatici.

In un contesto in cui l'agricoltura rappresenta una delle principali fonti di reddito, il **mancato accesso a sistemi irrigui affidabili** limita non solo la quantità, ma anche la qualità delle produzioni, riducendo la competitività dei prodotti locali.

Inoltre, l'**assenza di una gestione coordinata** delle risorse idriche e di piani di manutenzione sistematici aggrava ulteriormente la situazione.

Intervenire su queste infrastrutture non significa solo migliorare la produzione agricola, ma anche creare le condizioni per uno **sviluppo rurale più equilibrato**, resiliente e capace di attrarre investimenti nel medio-lungo periodo.

Prospettiva di Genere

Il **miglioramento delle infrastrutture agricole** assume un ruolo strategico nel ridurre le disuguaglianze esistenti tra uomini e donne nel settore rurale.

Le **donne**, spesso **responsabili della gestione** quotidiana delle attività agricole familiari, sono tra le più colpite dalla carenza di acqua e dall'inefficienza dei sistemi irrigui, dovendo sostenere un carico di lavoro fisico e organizzativo maggiore.

La **mancanza di accesso equo** alle risorse produttive limita inoltre la loro capacità di pianificare, investire e innovare.

Garantire **infrastrutture funzionanti e accessibili** significa quindi non solo aumentare la produttività complessiva, ma anche migliorare concretamente **le condizioni di lavoro delle donne**, favorire la loro partecipazione attiva nei processi decisionali legati alla gestione delle risorse naturali e rafforzare il loro ruolo economico all'interno delle comunità rurali.

Un approccio sensibile al genere richiede pertanto che le donne siano coinvolte nella pianificazione, gestione e monitoraggio degli interventi.



Forcimi i infrastrukturës dhe shërbimeve bujqësore

Rafforzamento delle infrastrutture e dei servizi agricoli

Problemët Problemi

- Infrastrukturë ujitëse dhe kulluese e amortizuar
- Menaxhim joefikas i burimeve ujore
- Ndikimet e ndryshimeve klimatike (thatësira, përmbytje)
- Akses i pabarabartë në burime midis burrave dhe grave
- Infrastrutture irrigue e di drenaggio obsolete
- Gestione inefficiente delle risorse idriche
- Impatti dei cambiamenti climatici (siccità, alluvioni)
- Accesso diseguale alle risorse tra uomini e donne

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes
- Hartimi i planeve lokale për menaxhimin e ujit
- Përdorimi i teknologjive të qëndrueshme për ujitje
- Përfshirja e komunitetit (përfshirë gratë) në menaxhimin e burimeve
- Riabilitazione e modernizzazione dei sistemi di irrigazione
- Creazione di piani locali di gestione dell'acqua
- Introduzione di tecnologie sostenibili per l'irrigazione
- Coinvolgimento delle comunità (incluse le donne) nella gestione delle risorse

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë - *Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve*
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Agjencia për Zhvillimin e Zonave Rurale (AZHBR)
- Ministria e Bujqësisë
- Agjencia për Zhvillimin e Investimeve (AIDA)
- Kooperativa bujqësore dhe shoqatat e prodhuesve lokalë
- Bashkia Lezhë
- Ministero dell'Economia e delle Finanze
- Agenzia per lo Sviluppo delle ZONE Rurali (AZHBR)
- Ministero dell'Agricoltura
- Agenzia per lo Sviluppo degli Investimenti (AIDA)
- Cooperative agricole e associazioni di produttori locali

Prioritet 8
Priorità 8



Zhvillimi i zinxhirit agro-ushqimor (ruajtje, përpunim, treg) Sviluppo della filiera agroalimentare (stoccaggio, trasformazione, mercato)

Një nga pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik të sektorit bujqësor lokal është **dobësia e zinxhirit agro-ushqimor**, veçanërisht në fazat e ruajtjes, përpunimit dhe tregtimit të produkteve.

Mungesa e infrastrukturave të përshtatshme, si magazina, frigoriferë dhe linja përpunimi, i detyron fermerët të shesin produktet menjëherë pas korres, shpesh me çmime të ulëta dhe në **kushte të pafavorshme tregu**.

Kjo ul ndjeshëm vlerën e shtuar që mund të gjenerohet në nivel lokal dhe kufizon mundësinë për të hyrë në tregje më të gjera, përfshirë ato turistike. Gjithashtu, **mungesa e standardizimit dhe paketimit** të duhur e bën produktin më pak konkurrues.

Prandaj, forcimi i zinxhirit të furnizimit nuk do të thotë vetëm përmirësim i kushteve ekonomike të prodhuesve, por edhe krijimi i **një sistemi të integruar** të aftë për të vlerësuar prodhimin lokal, për të promovuar identitetin territorial dhe për të stimuluar mundësi të reja punësimi.

Qasja Gjimore

Zhvillimi i zinxhirit të furnizimit agro-ushqimor ofron mundësi të konsiderueshme për përfshirjen ekonomike të grave.

Në zonat rurale, **gratë** shpesh përfshihen në përpunimin, ruajtjen dhe shitjen e produkteve, por ato veprojnë në **mjedise informale dhe me burime të kufizuara**.

Mungesa e ambienteve të përshtatshme i detyron ato të punojnë në kushte të pasigurta dhe të fitojnë **marzhe shumë të ulëta fitimi**.

Investimi në krijimin e infrastrukturës dhe aftësive përgjatë zinxhirit të furnizimit formalizon këto aktivitete, rrit vlerën e produkteve dhe forcon sipërmarrjen femërore.

Për më tepër, **promovimi i kooperativave dhe grupeve të prodhuesve** mund të nxisë një pjesëmarrje më të madhe të grave në proceset e vendimmarrjes dhe të përmirësojë aksesin e tyre në treg. Prandaj, një qasje gjithëpërfshirëse duhet të përfshijë ndërhyrje specifike për të mbështetur gratë në të gjitha fazat e zinxhirit të furnizimit.

Uno dei principali limiti allo sviluppo economico del settore agricolo locale è la **debolezza della filiera agroalimentare**, in particolare per quanto riguarda le fasi di stoccaggio, trasformazione e commercializzazione dei prodotti.

L'assenza di infrastrutture adeguate, come magazzini, celle frigorifere e impianti di trasformazione, costringe i produttori a vendere subito dopo la raccolta, spesso a prezzi bassi e in **condizioni di mercato sfavorevoli**.

Questo riduce significativamente il valore aggiunto che potrebbe essere generato a livello locale e limita la possibilità di accedere a mercati più ampi, inclusi quelli turistici. Inoltre, la **manca di standardizzazione e di packaging** adeguato rende i prodotti meno competitivi rispetto ad altre realtà.

Rafforzare la filiera significa quindi non solo migliorare le condizioni economiche dei produttori, ma anche **creare un sistema integrato** capace di valorizzare le produzioni locali, promuovere l'identità territoriale e stimolare nuove opportunità di impiego.

Prospettiva di Genere

Lo **sviluppo della filiera agroalimentare** offre importanti opportunità per l'inclusione economica delle donne.

Nelle aree rurali, **le donne** sono spesso coinvolte nelle attività di trasformazione, conservazione e vendita dei prodotti, ma operano in **contesti informali e con risorse limitate**.

La mancanza di strutture adeguate le costringe a lavorare in condizioni precarie e a ottenere **margin di guadagno molto ridotti**.

Investire nella creazione di infrastrutture e competenze lungo la filiera consente di formalizzare queste attività, aumentare il valore dei prodotti e rafforzare l'imprenditorialità femminile.

Inoltre, **la promozione di cooperative e gruppi di produttrici** può favorire una maggiore partecipazione delle donne nei processi decisionali e migliorare il loro accesso al mercato. Un approccio inclusivo deve quindi prevedere interventi specifici per sostenere le donne in tutte le fasi della filiera.



Zhvillimi i zinxhirit agro-ushqimor (ruajtje, përpunim, treg) Sviluppo della filiera agroalimentare (stoccaggio, trasformazione, mercato)

Problemët Problemi

- Mungesë magazinimi dhe frigoriferësh
- Mungesë e linjave të përpunimit lokal
- Standardizim dhe paketim i pamjaftueshëm
- Lidhje e dobët me tregjet
- Mancanza di magazzini e celle frigorifere
- Assenza di linee di trasformazione locali
- Standardizzazione e packaging insufficienti
- Debole collegamento con i mercati

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi i qendrave të grumbullimit dhe ruajtjes
- Investime në përpunim dhe paketim
- Trajnime për standarde cilësie dhe marketing
- Promovimi i markave lokale dhe shitjes direkte
- Creazione di centri di raccolta e stoccaggio
- Investimenti in impianti di trasformazione e confezionamento
- Formazione su standard di qualità e marketing
- Promozione di marchi locali e vendita diretta

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë - Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Agjencia për Zhvillimin e Zonave Rurale (AZHBR)
- Ministria e Bujqësisë
- Agjencia për Zhvillimin e Investimeve (AIDA)
- Kooperativa bujqësore dhe shoqatat e prodhuesve lokalë
- Bashkia Lezhë
- Ministero dell'Economia e delle Finanze
- Agenzia per lo Sviluppo delle ZONE Rurali (AZHBR)
- Ministero dell'Agricoltura
- Agenzia per lo Sviluppo degli Investimenti (AIDA)
- Cooperative agricole e associazioni di produttori locali

Prioritet 9
Priorità 9



Akses në financa dhe forcimi i sipërmarrjes lokale

Accesso alla finanza e rafforzamento dell'imprenditorialità locale

Akresi i kufizuar në instrumente financiare përbën një nga barrierat kryesore strukturore për zhvillimin ekonomik të zonave rurale në fjalë. Fermerët e vegjël, bizneset familjare dhe operatorët e turizmit përballen me **vështirësi të konsiderueshme në sigurimin e kredive** dhe financimeve, si për shkak të mungesës së garancive reale, ashtu edhe për shkak të procedurave burokratike komplekse të kërkuara nga institucionet financiare.

Kjo situatë kufizon ndjeshëm aftësinë e aktorëve lokalë për të investuar në inovacion, për të përmirësuar infrastrukturën prodhuese, për të diversifikuar aktivitetet dhe për t'u përshtatur me kërkesat e tregut. Për më tepër, **niveli i lartë i informalitetit** në ekonomi e përkeqëson këtë situatë, duke ulur mundësinë për të përfituar nga instrumentet financiare formale dhe duke krijuar një cikël të vazhdueshëm të produktivitetit të ulët dhe mungesës së investimeve.

Përmirësimi i aksesit në financa nuk nënkupton vetëm lehtësimin e kredidhënies, por edhe **ndërtimin e një ekosistemi mbështetës** për sipërmarrjen lokale, që shoqëron bizneset nga faza fillestare deri në konsolidim dhe zgjerim.

Qasja Gjimore

Nga perspektiva e qasjes gjimore, vështirësitë në aksesin në financa bëhen edhe më të theksuara për gratë, të cilat shpesh ndodhen në një **pozicion të pafavorshëm strukturor**.

Mungesa e pronësisë formale mbi tokën apo asetet, pjesëmarrja më e kufizuar në ekonominë formale dhe mungesa e historikut kreditor e bëjnë më të vështirë për gratë të përfitojnë nga kreditë dhe shërbimet financiare. Kjo kufizon mundësinë e tyre për të nisur ose zhvilluar aktivitete ekonomike, duke rritur **varësinë financiare** dhe duke ulur autonominë e tyre.

Për të adresuar këto pabarazi, është e nevojshme të promovohen **instrumente financiare gjithëpërfshirëse** dhe të targetuara, si mikrofinanca, fondet e garancisë dhe skemat e financimit të dedikuara për bizneset e drejtuara nga gratë. Njëkohësisht, është thelbësore të **ofrohen trajnime dhe mbështetje** në menaxhimin financiar, planifikimin e biznesit dhe aksesin në fondet publike, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe besimit të grave në sipërmarrje.

L'accesso limitato a strumenti finanziari rappresenta una delle principali barriere strutturali allo sviluppo economico delle aree rurali considerate. Piccoli agricoltori, microimprese familiari e operatori del turismo incontrano **difficoltà significative nell'ottenere credito** e finanziamenti, sia per la mancanza di garanzie reali, sia per la complessità delle procedure burocratiche richieste dagli istituti finanziari.

Questa situazione limita fortemente la capacità degli attori locali di investire in innovazione, migliorare le proprie strutture produttive, diversificare le attività e adattarsi ai cambiamenti del mercato. Inoltre, **l'elevato livello di informalità** economica riduce ulteriormente l'accesso a strumenti finanziari formali, creando un **circolo vizioso** tra bassa produttività, scarsa capacità di investimento e limitata crescita economica.

Rafforzare l'accesso alla finanza non significa soltanto facilitare l'erogazione di credito, ma anche **costruire un ecosistema favorevole** allo sviluppo imprenditoriale, capace di accompagnare le imprese locali lungo tutto il loro percorso di crescita, dalla fase di avvio fino al consolidamento e all'espansione.

Prospettiva di Genere

Da una prospettiva di genere, le difficoltà di accesso alla finanza assumono una dimensione ancora più critica per le donne, che si trovano spesso in una **posizione strutturalmente svantaggiata**.

La **mancanza di proprietà formale** di terreni o beni, una minore partecipazione ai circuiti economici formali e l'assenza di una storia creditizia riconosciuta rendono più difficile per le donne accedere a prestiti e strumenti finanziari. Questo limita la loro capacità di avviare o sviluppare attività imprenditoriali, rafforzando la **dipendenza economica** e riducendo le opportunità di autonomia.

Per affrontare queste disuguaglianze è necessario promuovere **strumenti finanziari inclusivi e mirati**, come programmi di microcredito, fondi di garanzia dedicati e schemi di finanziamento agevolato per imprese femminili. Parallelamente, è fondamentale **offrire percorsi di formazione** e accompagnamento su gestione finanziaria, pianificazione d'impresa e accesso ai fondi pubblici, in modo da rafforzare le competenze e la fiducia delle donne nel gestire attività economiche.



Akses në financa dhe forcimi i sipërmarrjes lokale

Accesso alla finanza e rafforzamento dell'imprenditorialità locale

Problemët Problemi

- Akses i kufizuar në kredi dhe subvencione
- Mungesë garancish dhe pronësie (sidomos për gratë)
- Procedura burokratike të ndërlikuara
- Nivel i lartë informaliteti
- Accesso limitato a credito e sovvenzioni
- Mancanza di garanzie e proprietà formale (soprattutto per le donne)
- Procedure burocratiche complesse
- Alto livello di informalità

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Thjeshtimi i procedurave për financim
- Krijimi i fondeve të garancisë dhe mikrofinancës
- Trajnime për menaxhim financiar
- Nxitje për formalizimin e biznesev
- Semplificazione delle procedure di accesso ai finanziamenti
- Creazione di fondi di garanzia e microcredito
- Formazione finanziaria per imprenditori e imprenditrici
- Incentivi per la formalizzazione delle attività

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë - *Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve*
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Agjencia për Zhvillimin e Zonave Rurale (AZHBR)
- Ministria e Bujqësisë
- Agjencia për Zhvillimin e Investimeve (AIDA)
- Bankat dhe institucionet financiare
- Bashkia Lezhë
- Ministero dell'Economia e delle Finanze
- Agenzia per lo Sviluppo delle ZONE Rurali (AZHBR)
- Ministero dell'Agricoltura
- Agenzia per lo Sviluppo degli Investimenti (AIDA)
- Banche e istituzioni finanziarie

Prioritet 10
Priorità 10



Zhvillimi i integruar i turizmit rural dhe lidhja me bujqësinë *Sviluppo integrato del turismo rurale e dei collegamenti con l'agricoltura*

Turizmi rural përfaqëson një **mundësi strategjike të rëndësishme** për diversifikimin ekonomik të zonave në fjalë, falë pranisë së burimeve natyrore, trashëgimisë kulturore dhe produkteve agro-ushqimore me cilësi të lartë.

Megjithatë, **zhvillimi aktual** i këtij sektori mbetet **i fragmentuar**, i paorganizuar dhe i ndikuar ndjeshëm nga sezonaliteti, duke kufizuar ndikimin ekonomik dhe shpërndarjen e përfitimeve në territor. **Mungesa e një strategjie të integruar** dhe e koordinimit ndërmjet institucioneve vendore, bizneseve dhe komunitetit pengon ndërtimin e një oferte turistike të strukturuar dhe konkurruese.

Gjithashtu, **lidhja e dobët ndërmjet bujqësisë dhe turizmit** nuk lejon shfrytëzimin e plotë të potencialit të produkteve vendase, gastronomisë dhe traditave lokale, të cilat mund të shërbejnë si elementë dallues të territorit.

Një qasje e integruar për zhvillimin e turizmit rural, e bazuar në krijimin e sinergjive ndërmjet sektorëve, planifikimin strategjik dhe valorizimin e burimeve lokale, mund të gjenerojë mundësi të reja të ardhurash, të përmirësojë cilësinë e ofertës dhe të rrisë atraktivitetin e zonës gjatë gjithë vitit.

Qasja Gjinore

Nga perspektiva e qasjes gjinore, turizmi rural ofron **mundësi të rëndësishme** për përfshirjen ekonomike dhe sociale të grave, por këto mundësi shpesh kufizohen nga kushte pune të pasigurta, informale dhe sezonale.

Gratë janë të përfshira në mënyrë të konsiderueshme në aktivitetet e mikpritjes, gastronomisë, artizanatit dhe promovimit të traditave lokale, por **rrallëherë janë në pozicione vendimmarrëse** ose menaxheriale dhe shpesh punojnë pa mbrojtje të mjaftueshme ekonomike dhe sociale. Kjo situatë ndikon në ruajtjen e niveleve të ulëta të të ardhurave dhe kufizon mundësitë për zhvillim profesional dhe sipërmarrës.

Zhvillimi i një **turizmi rural më të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm** kërkon krijimin e kushteve të favorshme për fuqizimin e grave, përmes mbështetjes së sipërmarrjes femërore, përmirësimit të cilësisë së punësimit dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të drejtë të përfitimeve ekonomike. Kjo nënkupton **përfshirjen aktive të grave** në planifikimin dhe menaxhimin e iniciativave turistike, si dhe **ofrimin e mbështetjes konkrete** përmes trajnimeve, aksesit në financa dhe krijimit të rrjeteve lokale të bashkëpunimit.

Il turismo rurale è una **leva strategica fondamentale** per la diversificazione economica delle aree considerate, grazie alla presenza di risorse naturali, tradizioni culturali e produzioni agroalimentari di qualità.

Tuttavia, il suo **sviluppo** attuale risulta ancora **frammentato**, poco coordinato e fortemente influenzato dalla stagionalità, con un impatto economico limitato e disomogeneo sul territorio. La **manca di una strategia integrata e condivisa** tra istituzioni locali, operatori economici e comunità riduce l'efficacia degli interventi e impedisce la costruzione di un'offerta turistica strutturata e competitiva.

Inoltre, la **debole connessione tra agricoltura e turismo** non consente di valorizzare pienamente il potenziale delle produzioni locali, della gastronomia e delle tradizioni, che potrebbero invece costituire un elemento distintivo dell'offerta territoriale.

Un **approccio integrato** allo sviluppo del turismo rurale, basato sulla creazione di sinergie tra settori, sulla pianificazione strategica e sulla valorizzazione delle risorse locali, può contribuire a generare nuove opportunità di reddito, migliorare la qualità dell'offerta e rafforzare l'attrattività del territorio durante tutto l'arco dell'anno.

Prospettiva di Genere

Il turismo rurale offre **opportunità significative** per l'inclusione economica e sociale delle donne, ma queste opportunità sono spesso limitate da condizioni di lavoro precarie, informali e stagionali.

Nga perspektiva gjinore, **ndikimi** i mungesës së shërbimeve rehabilituese është i **dyfishtë** dhe prek në mënyrë të thellë si vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara, ashtu edhe familjet e tyre.

Së pari, **vajzat dhe gratë** me aftësi të kufizuara përballen me një formë të qartë diskriminimi strukturor, pasi mungesa e trajtimeve të specializuara i lë ato **të pambrojtura**, me probleme që priren të përkeqësohen gradualisht dhe me një rrezik më të lartë për izolim.

Së dyti, barra bie në mënyrë të konsiderueshme mbi **nënat dhe gratë kujdestare**, të cilat **mbingarkohen me përgjegjësi** fizike, emocionale dhe ekonomike. Shpesh ato detyrohen të heqin dorë nga puna për t'u kujdesur për vajzat apo gratë me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuptim, mungesa e qendrave të rehabilitimit nuk përfaqëson thjesht një boshllëk në ofrimin e shërbimeve, por përbën një **tregues të qartë dhe të fortë të përjashtimit sistematik** të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga e drejta e tyre themelore për shëndet, zhvillim dhe një jetë të denjë.

Per le ragazze e le donne con disabilità a Lezhë e Shëngjin, la **totale assenza di servizi di riabilitazione** (fisioterapia, logopedia, terapia dello sviluppo) rappresenta una delle disuguaglianze più gravi rilevate sul campo. A differenza delle grandi aree urbane, dove questi servizi esistono sia nel settore pubblico che in quello privato, le **comunità costiere e rurali** risultano **completamente scoperte**.

Questa situazione genera una serie di conseguenze gravi che incidono direttamente sulla vita e sul benessere delle **ragazze e delle donne con disabilità**, così come delle loro famiglie. Senza trattamenti adeguati, non ricevono gli interventi sanitari e di sviluppo di base necessari per la vita quotidiana. Di conseguenza, il loro **sviluppo fisico e cognitivo** viene **ostacolato**, mentre le condizioni di salute tendono a peggiorare progressivamente nel tempo.

Le famiglie sostengono un **carico economico ed emotivo significativo**, essendo costrette a cercare servizi in altre città, spesso con costi elevati e continui sforzi logistici. I bambini con bisogni di sviluppo perdono opportunità fondamentali di **integrazione precoce nel sistema educativo**, elemento chiave per il loro futuro. Inoltre, la mancanza di servizi adeguati aumenta notevolmente l'**isolamento sociale delle ragazze e delle donne** con disabilità, collocandole in una posizione di marginalizzazione e privandole del supporto necessario per partecipare alla vita comunitaria.

Prospettiva di Genere

Dal punto di vista di genere, l'**impatto** della mancanza di servizi riabilitativi è **duplice** e colpisce profondamente sia le ragazze e le donne con disabilità, sia le loro famiglie.

In primo luogo, **le ragazze e le donne** con disabilità affrontano una chiara forma di discriminazione strutturale, poiché l'assenza di trattamenti specializzati le lascia **prive di protezione**, con problemi che tendono a peggiorare progressivamente e con un rischio maggiore di isolamento.

In secondo luogo, il carico ricade in modo significativo sulle **madri e sulle donne caregiver**, che si trovano **sovraccaricate di responsabilità** fisiche, emotive ed economiche. Spesso sono costrette ad abbandonare il lavoro per prendersi cura delle ragazze o donne con disabilità.

In questo senso, la mancanza di centri di riabilitazione non rappresenta semplicemente una lacuna nell'offerta dei servizi, ma costituisce **un chiaro e incisivo indicatore dell'esclusione sistematica** delle donne e delle ragazze con disabilità dal loro diritto fondamentale alla salute, allo sviluppo e a una vita dignitosa.



Mungesa absolute e qendrave të rehabilitimit, fizioterapisë dhe logopedisë

Assenza totale di centri di riabilitazione, fisioterapia e logopedia

Problemët Problemi

- Vajzat dhe gratë kanë akses të kufizuar në informacion dhe shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues për shkak të tabu-ve kulturore, mungesës së edukimit seksual, mungesës së shërbimeve miqësore dhe transportit të pamjaftueshëm.
- Le ragazze e le donne hanno un accesso limitato alle informazioni e ai servizi di salute sessuale e riproduttiva a causa di tabù culturali, della mancanza di educazione sessuale, dell'assenza di servizi youth-friendly e di trasporti insufficienti.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Vendosja e shërbimeve miqësore për të rinjtë në qendrat shëndetësore.
- Edukim seksual i integruar në shkolla dhe qendra komunitare.
- Fushata informuese për kontracepsionin, IST-të dhe kontrollet gjinekologjike.
- Vizita të lëvizshme shëndetësore për zonat rurale.
- Trajnime për mjekët e familjes për komunikim miqësor me vajzat dhe gratë.
- Attivazione di servizi “amici dei giovani” nei centri sanitari.
- Educazione sessuale integrata nelle scuole e nei centri comunitari.
- Campagne informative su contraccezione, IST e controlli ginecologici.
- Visite sanitarie mobili per le aree rurali.
- Formazione per i medici di famiglia sulla comunicazione inclusiva e sensibile con ragazze e donne.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- NjVKSH
- Shërbimi Shëndetësor Lezhë
- Shkollat
- Organizatat e grave
- Mjekët gjinekologë
- Donatorët
- Comune di Lezhë
- Unità di Coordinamento contro la Violenza Domestica (NjVKSH)
- Centro sanitario di Shëngjin
- Organizzazioni di donne
- Donatori
- Medici ginecologi
- Scuole

Prioritet 7
Priorità 7



Akses i kufizuar në tregun e punës dhe varësi nga punësimi sezonal

Accesso limitato al mercato del lavoro e dipendenza dal lavoro stagionale

Në Bashkinë Lezhë, dhe veçanërisht në Shëngjin, tregu i punës është i ndërtuar pothuajse tërësisht rreth sezonit turistik. Kjo e bën **punësimin tepër të paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm** për gratë, të cilat janë të mbipërfaqësuar në pozicione pune të ulëtpaguara, të pasigurta dhe pa kontrata.

Gjatë verës ato punojnë në hotele, restorante, struktura akomoduese, pastrim dhe shërbime mbështetëse. Por me mbarimin e sezonit, shumica mbeten **pa të ardhura dhe pa asnjë formë sigurie sociale**. Për shumë gra, sidomos nënat e reja, nënat kryefamiljare dhe ato që jetojnë në zona rurale përreth Shëngjinit, ky lloj punësimi nuk i përgjigjet nevojës për stabilitet ekonomik, duke i lënë ato në **pozitë vartësie financiare** dhe duke rritur stresin për mbijetesë gjatë muajve të dimrit.

Papunësia dhe mungesa e përfshirjes në ekonominë formale janë disa nga sfidat më të mëdha të komunitetit **Rom dhe Egjiptian** në Lezhë dhe Shëngjin. **Punësimi sezonal dhe joformal** dominues angazhimin ekonomik të tyre, duke mos ofruar siguri, kontrata apo mbrojtje ligjore. Bizneset shpesh hezitojnë të punësojnë anëtarë të komunitetit për shkak të paragjytimeve, mungesës së njohurive mbi skemat e subvencionimit dhe mungesës së besimit në aftësitë e tyre profesionale. Ky përjashtim e mban komunitetin në **varfëri të vazhdueshme** dhe i mohon atij mundësinë për integrim socio-ekonomik.

Qasja Gjimore

Varësia nga punësimi sezonal nuk është vetëm një çështje ekonomike, por një mekanizëm që riprodhon **pabarazinë strukturore** midis grave dhe burrave. Gratë në Lezhë dhe Shëngjin janë të pozicionuara në mënyrë të pabarabartë në tregun e punës për shkak të roleve tradicionale të kujdesit. Kjo ndarje gjinore e punës i shtyn gratë drejt **profesioneve me paga të ulëta** dhe pa perspektivë karriere, si pastrimi dhe shërbimet bazë. Këto punë nuk janë vetëm të paqëndrueshme, por edhe **pa mbrojtje të mjaftueshme**, duke i lënë gratë pa sigurime shoqërore, pa kontrata dhe pa të drejta të barabarta.

Jashtë sezonit, gratë humbasin çdo burim të ardhurash, duke u përballur me një **gjendje ekonomike të brishtë** që rrit varësinë nga partneri ose familja. Kjo kufizon autonominë e tyre ekonomike, dobëson fuqinë vendimmarrëse dhe ul pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale dhe publike.

Akresi i kufizuar në tregun e punës dhe varësia nga punësimi sezonal përbëjnë një formë të qartë të **pabarazisë gjinore**, e cila kërkon ndërhyrje strukturore, jo vetëm ekonomike.

Nel Comune di Lezhë, e in particolare a Shëngjin, il mercato del lavoro è costruito quasi interamente attorno alla stagione turistica. Ciò rende **l'occupazione estremamente instabile e imprevedibile** per le donne, che sono sovrarappresentate in posizioni lavorative a bassa retribuzione, precarie e prive di contratto. Durante l'estate lavorano in hotel, ristoranti, strutture ricettive, servizi di pulizia e attività di supporto. Tuttavia, con la fine della stagione, la maggior parte rimane **senza reddito e senza alcuna forma di sicurezza sociale**. Per molte donne, soprattutto giovani madri, madri capofamiglia e quelle che vivono nelle aree rurali intorno a Shëngjin, questo tipo di impiego non risponde al bisogno di stabilità economica, lasciandole in **una condizione di dipendenza finanziaria** e aumentando lo stress per la sopravvivenza durante i mesi invernali.

La disoccupazione e la mancata inclusione nell'economia formale rappresentano alcune delle principali sfide per le **comunità Rom ed Egiziana** a Lezhë e Shëngjin. **L'occupazione stagionale e informale** domina il loro coinvolgimento economico, senza offrire sicurezza, contratti o protezione legale. Le imprese spesso esitano ad assumere membri di queste comunità a causa di pregiudizi, della scarsa conoscenza dei meccanismi di sovvenzione e della mancanza di fiducia nelle loro competenze professionali. Questa esclusione mantiene le comunità in una condizione di **povertà persistente** e ne limita l'integrazione socio-economica.

Prospettiva di Genere

La **dipendenza dal lavoro stagionale** non è solo una questione economica, ma un meccanismo che riproduce la **disuguaglianza strutturale** tra donne e uomini. Le donne a Lezhë e Shëngjin sono posizionate in modo diseguale nel mercato del lavoro a causa dei ruoli tradizionali di cura.

Questa divisione di genere del lavoro spinge le donne verso **professioni a bassa retribuzione** e senza prospettive di carriera, come le pulizie e servizi di base. Questi lavori non sono solo instabili, ma anche **privi di adeguate tutele**, lasciando le donne senza protezione sociale, senza contratti e senza pari diritti.

Fuori stagione le donne perdono ogni fonte di reddito, ritrovandosi in una **condizione economica fragile** che aumenta la dipendenza dal partner o dalla famiglia. Ciò limita la loro autonomia economica, indebolisce il potere decisionale e riduce la loro partecipazione alla vita sociale e pubblica.

L'accesso limitato al mercato del lavoro e la dipendenza dal lavoro stagionale rappresentano una chiara forma di **disuguaglianza di genere** che richiede interventi strutturali, non soltanto economici.



Akses i kufizuar në tregun e punës dhe varësi nga punësimi sezonal

Accesso limitato al mercato del lavoro e dipendenza dal lavoro stagionale

Problemet Problemi

- Akses i kufizuar i grave në tregun e punës dhe varësi nga punësimi sezonal.
- Accesso limitato delle donne al mercato del lavoro e dipendenza dal lavoro stagionale.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi i modeleve të punësimit gjithëvjeter për gratë në sektorë alternativë jashtë turizmit.
- Trajnime profesionale për gra dhe vajza në profesione të kërkuara në treg.
- Skema mbështetëse për vetëpunësim të grave.
- Shërbime të kujdesit (çerdhe/pas-shkollore) që rrisin pjesëmarrjen në tregun e punës.
- Formalizimi i punëve sezonale dhe rritja e mbrojtjes për punëtorët.
- Creazione di modelli di occupazione annuale per le donne in settori alternativi al turismo.
- Formazione professionale per donne e ragazze in professioni richieste dal mercato.
- Schemi di sostegno per il lavoro autonomo femminile.
- Servizi di cura (asili nido/doposcuola) per aumentare la partecipazione al mercato del lavoro.
- Formalizzazione del lavoro stagionale e rafforzamento delle tutele per le lavoratrici.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Zyra Vendore e Punësimit
- Bizneset lokale
- DRTKSH
- OJF-të
- Donatorët
- Dhoma e Biznesit
- Comune di Lezhë
- Ufficio locale per l'impiego
- Imprese locali
- DRTKSH
- ONG
- Donatori
- Camera di Commercio.

Prioritet 8
Priorità 8



Mungesa e pronësisë mbi tokën dhe pasuritë dhe akses i ulët në financim dhe kredi

Mancanza di proprietà della terra e dei beni e limitato accesso a finanziamenti e crediti

Në Lezhë, **gratë** ndërtojnë pjesën më të madhe të ekonomisë familjare përmes punës, kujdesit dhe kontributit në bujqësi, por rrallë shihen si pronare.

Shpërndarja e pabarabartë e pronësisë mbi tokën e bën të pamundur për gratë të kenë akses në një nga burimet më të rëndësishme të kapitalit. Pronësia nuk është thjesht një certifikatë; ajo është **porta hyrëse për kredi, grante, investime** dhe të drejtën për të marrë vendime ekonomike. Pa këtë të drejtë, shumë gra ndodhen në një pozitë ku nuk mund të ndjekin iniciativat e tyre ekonomike, nuk mund të rrisin prodhimin bujqësor, nuk mund të marrin kredi bankare dhe nuk mund të zhvillojnë aktivitete të vetëpunësimit.

Në këtë kontekst, pronësia bëhet **një vijë ndarëse e qartë mes autonomisë dhe vartësisë**. Gratë që nuk kanë pronë varen nga burri, vëllezërit ose familjarët meshkuj për çdo vendim ekonomik, madje edhe për mundësinë për të hyrë në programe publike mbështetëse.

Mungesa e pronësisë është një formë **pabarazie strukturore** që e kufizon fuqizimin ekonomik të grave në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të preکشme.

Qasja Gjimore

Nga këndvështrimi gjinor, **mungesa e pronësisë** është një nga format më të fshehta, por edhe më të fuqishme të **pabarazisë strukturore** që prekin gratë në Bashkinë Lezhë.

Edhe pse **gratë** kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare përmes punës bujqësore, punëve të kujdesit dhe menaxhimit të ekonomisë së shtëpisë, ato **nuk gëzojnë të njëjtin status** juridik dhe ekonomik si burrat. Në shumë raste, gratë janë **kontribuese të padukshme**, të cilat punojnë tokën, por vendimet për investimet, shitjen apo zhvillimin bujqësor mbeten ekskluzivisht në dorën e pronarëve meshkuj. Në mënyrë paradoksale, gratë punojnë tokën, por nuk mund të përfitojnë prej saj.

Ky **boshllëk në pronësi** krijon një ndarje të qartë mes autonomisë dhe varësisë ekonomike. Gratë që nuk kanë pasuri të regjistruar në emrin e tyre mbeten të varura nga vendimet dhe vullneti i familjarëve meshkuj, duke e **përrjashtuar zërin e tyre nga proceset e vendimmarrjes ekonomike** dhe duke kufizuar fuqinë e tyre brenda familjes dhe komunitetit.

Në thelb, pronësia nuk është vetëm instrument ekonomik por një mekanizëm fuqizimi ose dobësimi social.

A Lezhë, **le donne** costruiscono gran parte dell'economia familiare attraverso il lavoro, la cura e il contributo all'agricoltura, ma raramente sono riconosciute come proprietarie.

La **distribuzione diseguale della proprietà** della terra rende impossibile per le donne accedere a una delle risorse di capitale più importanti. La proprietà non è solo un certificato: è la **porta d'ingresso a crediti, sovvenzioni, investimenti** e al diritto di prendere decisioni economiche. Senza questo diritto, molte donne si trovano in una posizione in cui non possono sviluppare le proprie iniziative economiche, aumentare la produzione agricola, accedere a prestiti bancari o avviare attività di autoimpiego.

In questo contesto, la proprietà diventa una chiara **linea di demarcazione tra autonomia e dipendenza**. Le donne che non possiedono beni dipendono dal marito, dai fratelli o da altri familiari maschi per ogni decisione economica, persino per la possibilità di accedere a programmi pubblici di sostegno.

La **mancanza di proprietà** rappresenta una **forma di disuguaglianza strutturale** che limita in modo diretto e tangibile l'empowerment economico delle donne.

Prospettiva di Genere

Dal punto di vista di genere, la **mancanza di proprietà** rappresenta una delle forme più nascoste, ma anche più potenti, di **disuguaglianza strutturale** che colpisce le donne nel Comune di Lezhë.

Sebbene **le donne** contribuiscano direttamente all'economia familiare attraverso il lavoro agricolo, le attività di cura e la gestione dell'economia domestica, **non godono dello stesso status** giuridico ed economico degli uomini. In molti casi, le donne sono **contributrici invisibili**: lavorano la terra, ma le decisioni sugli investimenti, sulla vendita o sullo sviluppo agricolo restano esclusivamente nelle mani dei proprietari uomini. In modo paradossale, le donne lavorano la terra, ma non possono beneficiarne.

Questo **divario nella proprietà** crea una netta distinzione tra autonomia e dipendenza economica. Le donne che non possiedono beni registrati a proprio nome restano dipendenti dalle decisioni e dalla volontà dei familiari maschi, venendo **escluse dai processi decisionali economici** e vedendo limitato il proprio potere sia all'interno della famiglia che nella comunità.

In sostanza, la proprietà non è solo uno strumento economico, ma un vero e proprio meccanismo di empowerment o di esclusione sociale.



Mungesa e pronësisë mbi tokën dhe pasuritë dhe akses i ulët në financim dhe kredi

Mancanza di proprietà della terra e dei beni e limitato accesso a finanziamenti e crediti

Problemët Problemi

- Mungesë pronësie mbi tokën dhe pasuritë për gratë në Lezhë dhe Shëngjin.
- Akses i kufizuar i grave në kredi, financim dhe programe mbështetëse për sipërmarrjen.
- Mancanza di proprietà della terra e dei beni per le donne a Lezhë e Shëngjin.
- Accesso limitato delle donne al credito, ai finanziamenti e ai programmi di supporto all'imprenditoria.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Fushata informuese për regjistrimin e pronësisë në emër të grave dhe për programet kombëtare dhe europiane të mbështetjes.
- Ndërgjegjësim për ndarjen e barabartë të trashëgimisë.
- Trajnime ligjore për gratë mbi të drejtat e pronësisë.
- Lehtësim i procedurave për bashkëpronësi në çift.
- Promovimi i skemave të kreditimit pa kolateral për gratë.
- Krijimi i programeve lokale të micro-granteve për gratë.
- Trajnime në edukim financiar, plan biznesi dhe marketing.
- Qendra këshillimi për sipërmarrjen femërore në Bashkinë Lezhë.
- Campagne informative per la registrazione della proprietà a nome delle donne e sui programmi nazionali ed europei di sostegno
- Sensibilizzazione sulla divisione equa dell'eredità.
- Formazioni legali per le donne sui diritti di proprietà.
- Semplificazione delle procedure per la comproprietà tra coniugi.
- Promozione di schemi di credito senza garanzie (collaterale) per le donne.
- Creazione di programmi locali di micro-grants per le donne.
- Formazione in educazione finanziaria, business plan e marketing.
- Centri di consulenza per l'imprenditoria femminile presso il Comune di Lezhë.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria e Kadastrës
- Ministria e Drejtësisë
- ZVPSH
- Dhoma e Biznesit
- Institucionet financiare
- AZHBR
- Ministria e Ekonomisë
- OJF-të për fuqizimin ekonomik të grave
- Donatorët
- Comune di Lezhë
- Direzione del Catasto
- Ministero della Giustizia
- ZVPSH
- Camera di Commercio
- Istituzioni finanziarie
- AZHBR
- Ministero dell'Economia,
- Istituzioni finanziarie,
- ONG per l'empowerment economico delle donne
- Donatori.

Prioritet 9
Priorità 9



Mungesa e aksesit në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara

Mancanza di accesso al mercato del lavoro per le persone con disabilità

Përfashtimi i personave me aftësi të kufizuara nga tregu i punës është një problem i dokumentuar gjerësisht në Shqipëri, por ai merr përmasa edhe më të rënda kur bëhet fjalë për kete kategori në Lezhë dhe Shëngjin.

Gjatë konsultimeve me komunitetin, vajzat me aftësi të kufizuara kanë theksuar se bizneset lokale shpesh tregojnë **indiferencë** ose hezitim për t'i punësuar.

Shumë prej tyre ndeshen me **paragjykime të hapura**, ku konsiderohen të paafta pavarësisht potencialit, dëshirës për të punuar apo formimit të tyre.

Për më tepër, bizneset nuk kanë njohuri mbi përshtatjen e thjeshtë të vendit të punës, e cila shpesh nuk kërkon investime të mëdha, por vetëm **ndërgjegjësim dhe vullnet**.

Skemat shtetërore që supozohet të subvencionojnë punësimin e PAK shpesh nuk zbatohen si duhet, duke mos krijuar nxitjen e nevojshme për punëdhënësit.

Si rezultat, vajzat me AK mbeten të **varura nga familja** dhe të ekspozuara ndaj izolimit social, varfërisë dhe shpesh edhe dhunës në familje.

Qasja Gjimore

Nga perspektiva gjimore, përfashtimi i vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara nga tregu i punës është **një nga format më të thella dhe më të shumfishta të diskriminimit strukturor**.

Në realitetin lokal të Lezhës dhe veçanërisht të Shëngjinit, bizneset shpesh i shmangen punësimit të personave me aftësi të kufizuara jo për mungesë kapaciteti, por për **mungesë informacioni dhe ndërgjegjësimi**. Punëdhënësit e konsiderojnë punësimin e një vajze me AK si “barrë” apo “komplikim”, duke mos e kuptuar se përshtatjet e vendit të punës shpesh janë minimale dhe kërkojnë vetëm organizim të brendshëm dhe vullnet. Ky paragjykim i rrënjësor bën që **vajzat të përfashtohen automatikisht** nga mundësitë që u ofrohen të rinjve të tjerë.

Për më tepër, skemat e shtetit për nxitjen e punësimit të PAK shpesh nuk zbatohen si duhet në terren. Kjo situatë krijon **një qark të mbyllur varfërie dhe përfashtimi**: vajzat nuk punësohen sepse nuk kanë përvojë dhe nuk kanë përvojë sepse nuk punësohen. Pa të ardhura, ato nuk mund të ndërtojnë autonomi, nuk mund të shkollohen më tej, nuk mund të marrin pjesë në jetën publike dhe nuk kanë mjete për t'u shkëputur nga situatat e dhunës apo abuzimit.

L'esclusione delle persone con disabilità dal mercato del lavoro è un problema ampiamente documentato in Albania, ma assume dimensioni ancora più gravi per questa categoria a Lezhë e Shëngjin.

Durante le consultazioni con la comunità, le ragazze con disabilità hanno sottolineato come le imprese locali mostrino spesso **indifferenza** o esitazione ad assumerle.

Molte si confrontano con **pregiudizi evidenti** essendo considerate incapaci nonostante il loro potenziale, la volontà di lavorare e la formazione.

Inoltre, le imprese non hanno conoscenze sulle semplici adattazioni dei posti di lavoro, che spesso non richiedono grandi investimenti ma solo **consapevolezza e volontà**.

I programmi statali destinati a incentivare l'occupazione delle persone con disabilità spesso non vengono applicati correttamente, mancando così l'incentivo necessario per i datori di lavoro. Di conseguenza, le ragazze con disabilità rimangono **dipendenti dalla famiglia** ed esposte all'isolamento sociale, alla povertà e, spesso, anche alla violenza domestica.

Prospettiva di Genere

Dal punto di vista di genere, l'esclusione delle ragazze e delle donne con disabilità dal mercato del lavoro rappresenta **una delle forme più profonde e multifattoriali di discriminazione strutturale**.

Nel contesto locale di Lezhë e, in particolare, di Shëngjin, le imprese spesso evitano di assumere persone con disabilità non per mancanza di capacità, ma per **carezza di informazione e consapevolezza**. I datori di lavoro percepiscono l'assunzione di una ragazza con disabilità come un “peso” o una “complicazione”, senza rendersi conto che le adeguate modifiche del posto di lavoro sono spesso minime e richiedono solo organizzazione interna e volontà. Questo pregiudizio radicato porta all'**esclusione automatica delle ragazze** dalle opportunità disponibili per altri giovani.

Inoltre, i programmi statali volti a incentivare l'occupazione delle persone con disabilità spesso non vengono applicati correttamente sul territorio. Questa situazione crea un **circolo vizioso di povertà ed esclusione**: le ragazze non vengono assunte perché non hanno esperienza e non acquisiscono esperienza perché non vengono assunte. Senza reddito, non possono costruire autonomia, proseguire gli studi, partecipare alla vita pubblica né disporre degli strumenti per liberarsi da situazioni di violenza.



Mungesa e aksesit në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara

Mancanza di accesso al mercato del lavoro per le persone con disabilità

Problemët Problemi

- Vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara përjashtohen nga tregu i punës dhe përballen me paragjyime, mungesë përshtatjesh dhe mungesë mbështetjeje institucionale.
- Le ragazze e le donne con disabilità sono escluse dal mercato del lavoro e si confrontano con pregiudizi, mancanza di adeguamenti e insufficiente supporto istituzionale.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Fushata lokale me bizneset për eliminimin e paragjyimeve dhe promovimin e punësimit të vajzave me AK.
- Trajnim për bizneset mbi përshtatjet e thjeshta të vendit të punës.
- Zbatim rigoroz i skemave të subvencionimit për punësimin e PAK.
- Trajtime profesionale të përshtatura për vajzat me AK.
- Campagne locali con le imprese per eliminare i pregiudizi e promuovere l'occupazione delle ragazze con disabilità.
- Formazione per le imprese sulle semplici adattazioni dei posti di lavoro.
- Applicazione rigorosa dei programmi di incentivo all'occupazione delle persone con disabilità.
- Formazioni professionali adattate alle esigenze delle ragazze con disabilità.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Zyra Vendore e Punësimit,
- Ministria e Shëndetësisë & Mirëqenies Sociale
- Bizneset lokale
- Dhomat e Biznesit
- OJF-të për PAK
- Shkollat profesionale
- Ufficio locale per l'impiego,
- Ministero della Salute e del Welfare,
- Imprese locali, Camere di Commercio,
- ONG per le persone con disabilità,
- Scuole professionali.

Prioritet 10
Priorità 10



Mungesa e logjistikës së transportit publik të aksesueshëm

Mancanza di una logistica del trasporto pubblico accessibile

Transporti publik përbën një element thelbësor për aksesin në arsim, punë, shërbime dhe jetën shoqërore. Megjithatë, në Lezhë dhe Shëngjin, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara përballen me **pengesa të mëdha në lëvizje** për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatur.

Autobusët shpesh nuk kanë rampa ose ulëse të rezervuara, ndalesat nuk janë të aksesueshme, dhe drejtuesit e mjeteve nuk janë gjithmonë të trajnuar për të ofruar **mbështetje të duhur**.

Këto mangësi i detyrojnë shumë vajza me aftësi të kufizuara të qëndrojnë të mbyllura në shtëpi, të izoluara dhe të varura nga familjarët, duke humbur mundësi të rëndësishme për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike. Pa transport publik të aksesueshëm, është jashtëzakonisht e vështirë të ndjekin shkollën, të marrin pjesë në trajnime, të kenë akses në shërbime shëndetësore ose të shkojnë në punë.

Mungesa e lëvizjes autonome bëhet kështu një barrierë strukturore që kufizon përfshirjen sociale, autonominë dhe zhvillimin personal të grave me aftësi të kufizuara, duke rritur rrezikun e izolimit dhe të varfërisë.

Qasja Gjinore

Mungesa e transportit të aksesueshëm nuk është vetëm një çështje infrastrukture, por një formë e qartë **përgjashtimi sistemik** që prek në mënyrë disproporcionale vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Aksesimi i transportit publik është një element themelor i **autonomisë personale**, pasi përcakton mundësinë për të shkuar në shkollë, për të punuar, për të marrë shërbime shëndetësore ose sociale dhe për të marrë pjesë në jetën komunitare. Kur transporti nuk është i përshtatshëm, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara humbasin jo vetëm mundësinë e lëvizjes, por edhe të drejtën për pjesëmarrje dhe përfshirje të barabartë.

Kjo situatë i vendos ato në një **pozicion me shumëfishë pabarazie**. Ato përballen jo vetëm me stigma dhe barrierat e aftësisë së kufizuar, por edhe me pritshmëritë shoqërore që i detyrojnë të mbështeten te familjarët, shpesh te nëna, motra ose gratë e tjera të shtëpisë, duke krijuar një **zinxhir të dyfishtë varësie**. Transporti i paaksesueshëm është një nga arsyt kryesore pse vajzat me aftësi të kufizuara mbeten të padukshme në hapësirat publike dhe pse zëri i tyre mungon në politikat lokale.

Në këtë mënyrë, **pabarazia gjinore dhe pabarazia e aftësisë së kufizuar** ndërthuren dhe forcojnë njëra-tjetrën.

Il trasporto pubblico rappresenta un elemento fondamentale per l'accesso all'istruzione, al lavoro, ai servizi e alla vita sociale. Tuttavia, a Lezhë e Shëngjin, le ragazze e le donne con disabilità affrontano **ostacoli significativi alla mobilità** a causa della mancanza di infrastrutture adeguate.

Gli autobus spesso non sono dotati di rampe né di posti a sedere riservati, le fermate non sono accessibili e gli autisti non sempre ricevono formazione per fornire **assistenza adeguata**.

Queste carenze costringono molte ragazze con disabilità a rimanere confinate in casa, isolate e dipendenti dai familiari, perdendo opportunità cruciali di partecipazione sociale ed economica. Senza un trasporto pubblico accessibile, è estremamente difficile frequentare la scuola, partecipare a corsi di formazione, accedere a servizi sanitari o recarsi al lavoro.

La **mancanza di mobilità autonoma** diventa così una barriera strutturale che limita l'inclusione sociale, l'autonomia e lo sviluppo personale delle donne con disabilità, accentuando il rischio di isolamento e vulnerabilità economica.

Prospettiva di Genere

La **mancanza di trasporto accessibile** non è solo una questione infrastrutturale, ma una forma chiara di **esclusione sistemica** che colpisce in maniera sproporzionata le ragazze e le donne con disabilità.

L'accesso ai trasporti pubblici è un elemento fondamentale per l'**autonomia personale**, poiché determina la possibilità di andare a scuola, lavorare, usufruire di servizi sanitari o sociali e partecipare alla vita comunitaria. Quando il trasporto non è adeguato, le donne e le ragazze con disabilità perdono non solo la possibilità di muoversi, ma anche il diritto alla partecipazione e all'inclusione paritaria.

Questa situazione le pone in una **condizione di multipla disuguaglianza**. Esse affrontano non solo stigma e barriere legate alla disabilità, ma anche le aspettative sociali che le costringono a dipendere dai familiari, spesso madri, sorelle o altre donne della casa, creando così un **doppio circolo di dipendenza**. Il trasporto non accessibile è una delle principali ragioni per cui le ragazze con disabilità restano invisibili negli spazi pubblici e perché la loro voce manca nelle politiche locali.

In questo modo, la **disuguaglianza di genere** e la **disuguaglianza legata alla disabilità** si intrecciano e si rafforzano a vicenda.



Mungesa e logistikës së transportit publik të aksesueshëm

Mancanza di una logistica del trasporto pubblico accessibile

Problemet Problemi

- Transport publik jo i aksesueshëm për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara.
- Trasporto pubblico non accessibile per le ragazze e le donne con disabilità.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Investime në rampa, ulëse të dedikuara dhe mjete të aksesueshme.
- Trajtime për drejtuesit e mjeteve mbi mbështetjen ndaj PAK.
- Vendosje e standardeve të qarta të aksesueshmërisë në kontratat e transportit publik.
- Hartimi i linjave të transportit që mbulojnë shkollat, qendrat e shërbimeve dhe hapësirat komunitare.
- Subvencione për transport të përshtatshëm për vajzat me AK.
- Investimenti in rampe, posti a sedere riservati e mezzi accessibili.
- Formazione per gli autisti sui supporti alle persone con disabilità.
- Definizione di standard chiari di accessibilità nei contratti di trasporto pubblico.
- Progettazione di linee di trasporto che colleghino scuole, centri di servizi e spazi comunitari.
- Sussidi per un trasporto adeguato per le ragazze con disabilità.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Operatorët e transportit publik
- Ministria e Infrastrukturës
- ZVPSH
- OJF-të për të drejtat e PAK
- Këshilli Bashkiak
- Comune di Lezhë
- Operatori del trasporto pubblico
- Ministero delle Infrastrutture
- Ufficio per le Persone con Disabilità
- ONG per i diritti delle persone con disabilità
- Consiglio Comunale

Prioritet 11
Priorità 11



Mungesë sigurie në hapësirat publike, sidomos për vajzat e reja

Mancanza di sicurezza negli spazi pubblici, soprattutto per le ragazze giovani

Mungesa e sigurisë në hapësirat publike dhe në mjediset online përbën një nga sfidat më të theksuara për vajzat dhe gratë e reja në Bashkinë Lezhë, veçanërisht në zonën turistike të Shëngjinit. Siguria publike është e lidhur ngushtë me mirëqenien, **lirinë e lëvizjes** dhe aftësinë e vajzave për të marrë pjesë në jetën sociale dhe komunitare. Megjithatë, realiteti lokal tregon se shumë prej tyre përballen me **situata të vazhdueshme pasigurie**, të cilat prekin drejtpërdrejt mënyrën se si ato ndërveprojnë me mjedisin që i rrethon.

Hapësirat publike shpesh **nuk janë të ndricuara, të izoluara** ose pa prani të mjaftueshme policore e komunitare, duke krijuar një atmosferë pasigurie sidomos gjatë mbrëmjes dhe në periudhat jashtë sezonit turistik. Rugët anësore, stacionet e transportit publik, zonat pranë plazhit dhe hapësirat rekreative që shfrytëzohen më shumë nga turistët raportohen nga vajzat si zona ku ndihen të ekspozuara ndaj **ngacmimeve verbale, sjelljeve të padëshiruara dhe situatave të rrezikshme**.

Qasja Gjinore

Nga një këndvështrim gjinor, kjo situatë i ekspozon vajzat ndaj një **forme të shumëfishtë të pabarazisë dhe dhunës**. Vajzat shpesh përballen me stigmë ose fajësim nëse raportojnë ngacmime të ndodhura në publik ose online. Normat seksiste dhe seksualizimi i trupit të vajzave krijojnë presion psikologjik dhe social, duke i bërë ato të ndihen objekt i vëmendjes së padëshiruar dhe të rrezikut të vazhdueshëm. Për më tepër, familjet shpesh ushtrojnë kontroll të shtuar mbi lëvizjet e vajzave për t'i "mbrojtur", gjë që në praktikë kufizon autonominë e tyre personale dhe pjesëmarrjen në aktivitete shoqërore, kulturore apo profesionale.

Kjo situatë jo vetëm që cenon **lirinë e vajzave**, por prodhon efekte afatgjata në jetën e tyre. Mungesa e sigurisë ul aftësinë e tyre për të lëvizur lirisht në komunitet, rrit nivelin e **ankthit dhe pasigurisë emocionale** dhe i pengon ato të marrin pjesë në aktivitete që janë thelbësore për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Pasojat shtrihen në fusha të ndryshme nga zhvendosja drejt izolimit social, deri te rreziku i shtuar për abuzime seksuale dhe shfrytëzim.

Në terma afatgjatë, mungesa e sigurisë fizike dhe digjitale ndikon negativisht në vetëbesimin e vajzave, në aspiratat e tyre arsimore dhe profesionale, si dhe në aftësinë e tyre për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme në komunitet dhe në familje.

La **mancanza di sicurezza negli spazi pubblici** rappresenta una delle sfide più significative per le ragazze e le donne giovani nel Comune di Lezhë, in particolare nella zona turistica di Shëngjin. La sicurezza pubblica è strettamente legata al benessere, alla **libertà di movimento** e alla capacità delle ragazze di partecipare alla vita sociale e comunitaria. Tuttavia, la realtà locale mostra che molte di loro affrontano **situazioni di insicurezza continue**, che incidono direttamente sul modo in cui interagiscono con l'ambiente circostante.

Gli **spazi pubblici** spesso **non sono illuminati**, sono **isolati** o privi di sufficiente presenza di polizia e controllo comunitario, creando un'atmosfera di insicurezza soprattutto di sera e nei periodi fuori stagione turistica. Strade secondarie, stazioni dei trasporti pubblici, zone vicine alla spiaggia e aree ricreative maggiormente frequentate dai turisti vengono segnalate dalle ragazze come luoghi in cui si sentono esposte a **molestie verbali, comportamenti indesiderati e situazioni pericolose**.

Prospettiva di Genere

Da una prospettiva di genere, questa situazione espone le ragazze a una **forma multipla di disuguaglianza e violenza**. Le ragazze si trovano spesso ad affrontare stigma o colpevolizzazione quando segnalano molestie avvenute in spazi pubblici o online. Le norme sessiste e la sessualizzazione del corpo femminile generano pressioni psicologiche e sociali, facendo sì che si sentano oggetto di attenzioni indesiderate e di un rischio costante. Inoltre, le famiglie esercitano spesso un **controllo maggiore sui movimenti** delle ragazze per "proteggerle", il che nella pratica limita la loro autonomia personale e la partecipazione ad attività sociali, culturali e professionali.

Questa situazione non solo compromette **la libertà delle ragazze**, ma produce anche effetti a lungo termine sulla loro vita. La mancanza di sicurezza riduce la loro capacità di muoversi liberamente nella comunità, aumenta i livelli di **ansia e insicurezza emotiva** e impedisce loro di partecipare ad attività fondamentali per il loro sviluppo personale e professionale. Le conseguenze si estendono a diversi ambiti, dall'isolamento sociale fino a un maggiore rischio di abusi e sfruttamento.

Nel lungo periodo, la mancanza di sicurezza fisica incide negativamente sull'autostima delle ragazze, sulle loro aspirazioni educative e professionali e sulla capacità di costruire relazioni sane all'interno della comunità e della famiglia.



Mungesë sigurie në hapësirat publike, sidomos për vajzat e reja

Mancanza di sicurezza negli spazi pubblici, soprattutto per le ragazze giovani

Problemët Problemi

- Vajzat dhe gratë përballen me pasiguri në hapësirat publike dhe në mjediset online. Rrugët e pandricuara, zonat e izoluara dhe fluksi turistik rrisin rrezikun e ngacmimeve dhe sjelljeve të rrezikshme. Vajzat janë të ekspozuara ndaj dhunës online.
- Le ragazze e le donne affrontano insicurezza negli spazi pubblici e negli ambienti online. Strade non illuminate, zone isolate e il flusso turistico aumentano il rischio di molestie e comportamenti pericolosi. Le ragazze sono inoltre esposte alla violenza online.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Ndriçim publik i standardizuar në zonat e rrezikshme.
- Krijimi i patrullave të sigurisë në zonat turistike.
- Hapësira të sigurta rinore dhe qendra komunitare për vajzat.
- Fushata kundër dhunës online dhe sigurisë digjitale në shkolla.
- Hartimi i protokolleve të raportimit për abuzimet online.
- Trajnime për mësuesit, prindërit dhe stafin e shkollave për sigurinë online
- Illuminazione pubblica standardizzata nelle aree a rischio.
- Creazione di pattuglie di sicurezza nelle zone turistiche.
- Spazi sicuri per i giovani e centri comunitari per le ragazze.
- Campagne contro la violenza online e per la sicurezza digitale nelle scuole.
- Elaborazione di protocolli di segnalazione per gli abusi online.
- Formazione per insegnanti, genitori e personale scolastico sulla sicurezza online

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Lezhë
- Policia e Shtetit
- NjVKSH
- Shkollat
- Qendra Rinore
- Operatori i Ndriçimit Publik
- OJF-të
- Platforma Online
- Donatorët
- Comune di Lezhë
- Polizia di Stato
- NjVKSH
- Scuole
- Centri giovanili
- Operatore dell'illuminazione pubblica
- ONG
- Piattaforme online
- Donatori

Prioritet 12
Priorità 12

Axenda e Grave Rurale



Agenda delle Donne Rurali